

# KOQËRJA

Ballina: Marsela Ceno

Pse në Kosovë  
Zoti po e bën  
llugë

Parku  
i të dashuruarve  
në Kosovë

**DR. MED.  
MARSELA CENO**  
*në jetë e profesion  
gjithmonë triumfuese*

Kaltrina  
Zeqiri-Kastrati,  
e rralla shqiptare  
në Zvicër

A ta pres  
të dashurin  
që është në burg

Në Prishtinë  
krushqit marrin  
nusen gabimisht

Prej se u ndava  
nga burri  
u kënaqa

UB me takime,  
aktivitete,  
suksese





MIRAGE®



DIMENSIONI:  
60x60x20MM

60x60x20MM

60x60x20MM

SASIA 26.64<sup>M2</sup>

 DINO  
QERAMIKA

+383 49 566 667  
[www.dinoqeramika.store](http://www.dinoqeramika.store)



# *Kujt i teket boton diçka!*

*Ne, shqiptarët, nuk mund të ankohe mi sa i përket botimit të librit. Vit për vit botohen libra të ndryshëm dhe me bollëk. Por, mungesa e kritikës, mungesa e trajtimit nga ana e medimeve, e edhe mungesa e një kontrolli institucional, ka bërë që 90 për qind e këtyre botimeve të jenë gjithçka tjetër, por jo edhe produkt që do të mund të quhet libër...*

Në fakt, në fushën e botimeve ka kohë që mbretëron një anarki e vërtetë, e cila vazhdon të ushqehet në mënyrë të pavetëdijshme. Botimin e titujve pa vlerë e përcjellë një indiferencë e çuditshme, por edhe

një heshtje e turpshme. Edhe për këtë të keqe, që e ka katandisur shoqërinë shqiptare, mungon debati, qoftë ai edhe debat sipërfaqësor.

## **BOTIMI ËSHTË BËRË MODË, JO NEVOJË SHPIRTËRORE!**

Botimi është bërë më shumë modë se sa nevojë shpirtërore. Tendencat e botimit të "librave shkencorë", të atyre shumë individëve që gjetën "hapësirë pjellore" për t'u bërë me tituj shkencorë, tregojnë se, si pasojë e mungesës së një mekanizmi kontrollues, këta tituj nuk e kanë as nivelin e një hartimi të thjeshtë shkollor! E, të mos flasim për botimin e përmblendhjeve me poezi, besa edhe të ndonjë romani aty-këtu, sepse edhe nxënës të shkollave fillore botojnë romane, e edhe të tjerë që e quajnë veten "intelektual", e, në fakt, në një titull të një romani të botuar kohë më parë më ra t'i vëreja tre gabime! E, mu ai "intelektual", në parathënie të atij romani, thotë se i ka 100 romane në dorëshkrim, por që nuk ka mundësi materiale t'i botojë, meqë nuk po mundet të gjejë sponsorë.

## **KATASTROFA ME "TAKIMET POETIKE"...**

Natyrisht, nuk duhet pritur që dikush të skuqet nga kjo zallahi që i bëhet librit shqip, sepse akoma vazhdon të trajtohet si çështje e dorës së dhjetë. E, kjo fatkeqësi ka bërë që të prodhohen të tjera absurde, të cilat gjejnë vend të viltshëm në mentalitetin provincial, të cilin mentalitetin e kultivojmë me një pasion të çuditshëm. Bëhet fjalë për numrin e madh të "takimeve poetike", në të cilat lexohen fjalë të hedhura në letër (e letra duron gjithçka). Nga ana tjetër, kurrë nuk pati përpjekje që shqiptarët t'i tejkalojnë klanet e ndryshme "letrare", por edhe ta lënë anash mentalitetin provincial dhe të organizojnë takime të vërteta poetike, me gjithë organizimin e duhur. E, të mos flasim për promovimet tragjike-komike, që janë bërë dukuri të përditshme, në të cilat thuhet vetëm fjalë të mira, pa marrë parasysh vlerën e librit të botuar! Në promovimet e tilla nuk ka kritikë, por vetëm lavde... Dhe, këtu mbyllet gjithçka...

**S. Rama**



# Ku ndodhet "Parku i të dashuruarve" në Kosovë?

*Shpella e mermertë në fshatin Gadime e Poshtme, është një fenomen i papërsëritshëm në botën e speleologjisë. Jo pse nuk ka shpella të tjera në botë, por pse një zonë gjeografike e shpellës nga horizonti lindor i ka thyer rregullat e fizikës...*

Për çudi, tash shpella vizitohet më pak se çdo vit tjetër. Pronarët e shpellës dhe ciceronët janë ndër-

ruar sipas pushteteve që kanë ardhur në nivel republike e komune! Në kohën e Jugosllavisë shpella ka pasur statutin e organizatës së punës, me drejtor e zëvendësdrejtor në krye.

Ekipi i ciceronëve kishte mbajtur trajnime dhe duhej të ishin me përkatësi profesionale kimistë ose biologë.

Ishte fillimisht organizatë nën drejtorinë kosovare të Ambientit dhe Mbrojtjes së Natyrës.

E, me fillimin e viteve 90 shpella hyri në fazën kritike të investimeve dhe statuti i saj, me ikjen e punëtorëve u shua, duke mbetur në dorë private të mbrojtjes dhe vizitave.

Mirëpo, pas lufte shpella vazhdoi punën duke e mbajtur reputacionin falë familjes së Haredin Tashollit, i biri i Nazifit.

Nazif Tasholli me djem e nipër e ruajtën dhe mbrojtën shpellën edhe gjatë luftës së vitit 1999, kur forcat paramilitare-ushtarake donin ta shkatërronin, duke i thyer produktet mijëvjeçare të shpellës, për çka flitej se ishin porositur ta shkatërronin në tërësi, duke i thyer e plaçkitur figurat me emrat e ndryshëm brenda shpellës, si: "Syri i Kosovares", "Burgu e Alkatrazit", "Pianoja e Akil Kocit", "Këmba e elefantit", "Stolitë aragonite", "Dhurata e 8 Marsit", "Dallëndyshja e etur", "Dora e



Hysen Tasholli

njeriut”, “Përkrenarja e Skënderbeut”, “Parku i të dashuruarve” dhe “Mjekra e Skënderbeut”.

## PUNOJNË NJERËZ PA PËRGATITJE PROFESIONALE!

Hysen Tasholli, speleolog i kualifikuar, ka thënë për revistën tonë, “Kosovarja”, se shpella sot është pa përkujdesje të duhur profesionale.

Ai tutje ka folur me brenga për shpellën, duke thënë se ata që sot punojnë në shpellë nuk e dinë rëndësinë e kristaleve.

“Sot në ekipin e ciceronëve të shpellës punojnë njerëz që nuk kanë lidhje me përkatësinë profesionale të kimisë së shpellës. Unë nuk jam aty, edhe pse për shumë vite kam qenë njeriu i parë nga ciceronët që në mënyrë profesionale i kam kryer punët në ligjërim dhe në ruajtjen e shpellës. Ka njerëz që kur hyjnë brenda janë të prirë t’i prekin figurat ose ka edhe që duan t’i shkëpusin ato në përgjithësi!

E, ciceronët e kanë për obligim të mos lejojnë të ndodhin këto gjëra...

## KUSH I EMËROI FIGURAT E SHPELLËS?

Janë figura të shumta brenda shpellës që kanë marrë emërtime të ndryshme.

Emërtimet i kanë bërë njerëzit eminentë që kanë hyrë për vizita në shpellë. Ka pasur ekipe profesionale që kur kanë parë diçka që

identifikohet në formë me dikë a me diçka, kanë bërë emërtime, për shembull, kanë thënë sa po ngjanë në syrin e femrës kosovare dhe ne e kemi pagëzuar “Syri i Kosovares”, e kështu me radhë...

Unë kam punuar me Nazifin e ndjerë, për çka mendoj gjithmonë se ai e ka mbrojtur dhe ruajtur më së miri shpellën e Gadimes në kohët më të vështira.

Ne e kemi mbrojtur dhe ruajtur me fanatizëm jo vetëm si punëtorë të shpellës, por edhe si gadimas që e kanë në pronësi shpellën si fshat, sepse, falë shpellës, qysh në vitet 70 kemi përfituar asfaltin në fshat, sallën sportive, me ç’rast u krijua ekipi i volejbollit “Shpella”, i cili arriti të bëhej kampion i shumëfishtë i Kosovës dhe ekipi më kualitativ në ligën e parë të Kosovës gjithmonë”, thekson Hysen Tasholli, ciceron i shpellës për shumë vjet, speleolog i kualifikuar.

## SHPELLA QË THEU LIGJET E FIZIKËS!

“Stolitë aragonite” në kuartin lindor të shpellës janë element unikat në botën e shpellave, e që i ka thyer ligjet e fizikës në formulën e njohur 3,14.

Sipas ligjeve të fizikës, figurat ose duhet të shkojnë pingul tatëpjetë ose lart në mënyrë të drejtë, thonë ligjet e fizikës.

Ndërkaq, në Shpellën e Gadimes figurat shkojnë tërthorazi, duke i thyer rregullat e fizikës.

Ajo që nuk di opinioni është se shpella e mermertë në Gadime ndodhet në kodrën e quajtur “Murturi” dhe lidhet nën lumin “Kli-syrka”, që vjen përmes fshatit fund e krye dhe del në kodrën tjetër me emrin “Surgjaku”.

Këtë lidhje e tregojnë edhe librat shkencorë, të cilët tregojnë se nën shpellë është një liqe me ujë, i cili dëgjohet kah lëviz me valët e baticave.

S. Krivaça



# Pse në Kosovë Zoti po e bën llugë e më llugë?

*Në Kosovën tonë shtet që 24 vjet pas luftime po shkon llugë e më llugë! Sa herë që ofrohet paqja, diçka kërcet dhe i del tymi tjetër kah...*

Populli e ka një thënie: "Nusja e mirë, por njërin sy qorr!". E, kështu po ndodh edhe me Kosovën tonë. Sa herë që qetësohet gjendja dhe njeriu krijon përshtypjen se gjithçka është mirë, kërcet diçka dhe i del tymi dika...

Mbase, pse më nuk jemi mirë si dikur me ndërkombëtarët, me shpëtimtarin më të madh – Amerikën?!

Apo...

E, këtë po e ilustruj me një ngjarje jete:

Një djalë ishte ulur në kateteri. Para vetes kishte një gotë të mbushur. Në moment në kafene hyn një vagabond, duke e hapur derën me shqelm.

Të pranishmit frikësohen nga sjellja e tij, e djaloshi s'leviz nga vendi. Vagabondi iu ofrua djaloshit, ia mori gotën që e mbante para vetes dhe e piu ujin që ndodhej në të...

Në çast, djaloshi i tha: "Nuk po më shkon asgjë mirë. Secilën punë që po e nisi po më dështon! Së pari, nisa të punoj kamerier, por më përzuri pronari i kafenesë, sepse e derdhja kafen derisa ia qoja mysafirrit...

Pastaj, gjeta punë të hekuros rroba, por edhe aty më përzuri shefi se i djegia teshat! Tutje gjeta një punë të shisja rroba në rrugë, por më kishte zërë gjumi dhe

m'i kishin vjedhur disa sosh e boshi më përzuri nga puna! Kështu, largim pas largimi, u lodha nga dështimet e përditshme dhe mezi i tubova paratë për të blerë helm që t'i jepja fund jetës.

Por, as helmin s'ma le ta pija, sepse erdhe ti dhe ma pive helmin që e kisha për t'i dhënë fund jetës!". Kështu është puna edhe me politikanët tanë. Çdo punë që nisin nuk e përfundojnë kurrë! E, në anën tjetër, flasin për rezultate, për arritje të jashtëzakonshme, e punët po shkojnë llugë, madje më llugë se asnjëherë më parë...

**Safet Krivaça**



# E PAÇIM AMERIKËN PA POLITIKANËT TANË!



**I DYTI:** Ncncncnc...

**I KATËRTI:** Po, çka ndodhi bre, çka u bë?!

**I DYTI:** Po qysh bre çka u bë?! Nuk është mahi me shqiptarë... Shumë të parehatshëm, shumë të çuditshëm, shumë interesantë...

**I TRETË:** E, pse bre, vëlla? Po na trego tash se m'plase!

**I DYTI:** Po ju, a përcillni ndonjë lajm në televizor a portal, ore?!

**I TRETË:** Po ti, na trego për çka e ke fjalën?

**I DYTI:** Po qysh, bre, nuk po e dëgjojmë Amerikën?! Nuk po e dëgjojmë shtetin që na çliroi, na bëri shtet?!

**I KATËRTI:** Qe besa, hiç keq s'e ke. A ju kujtohet edhe sa ishim ndër këmbët e shkaut si vinin senatorët e kongresmenët amerikanë te Rugova dhe na përkrahnin

e na jepnin kurajë që të qëndrojmë, të çlirohemi e të bëhemi shtet?!

**I TRETË:** O Zot, krejt n'rregull, por sot pse ky muhabet?

**I KATËRTI:** Po, cili shkrimtar yni pat thënë se armiku i shqiptarit është vetë shqiptari, andaj nuk është e habitshme...

**I DYTI:** Qy - qy - qy... po i mençur na u ke ba ti, ore?! E meriton një çaj prej meje...

**I KATËRTI:** E meritoj, pra, hajde qite çajin!

**I TRETË:** Hajt, bre, se kalojnë të gjitha...

Rroftë Amerika se krejt rregullohen! Po, hajde ta pimë edhe nga një çaj dhe e lëmë këtë muhabet...

**I DYTI:** E paçim Amerikën pa politikanët tanë!

Na bëftë mirë çaji!

**Gani Dili**

## KOSOVARJA

magazinë e pavarur  
për familje

[www.kosovarja.al](http://www.kosovarja.al)

**Pronar dhe botues:**

Gani DILI

**Redaktor përgjegjës:**

Isa ILAZI

**Menaxher:**

Driton DILI

**Redaksia:**

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

**Dizajni:**

Labinot Bërbotovci

**Adresa e redaksisë:**

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

**Marketing:**

Tel: +383 44 143 448;

Email: [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)

Në ballinë: Marsela Ceno

# Dr. Med. Marsela Ceno në jetë e profesion gjithmonë triumfuese

Marsela Ceno është doktoreshë, grua e zonja dhe me histori motivuese. Ja ka dalë suksesshëm të hapërojë në jetë, pa e kthyer asnjëherë kokën pas. Ka lindur në qytetin e bukur të Korçës, më 10 nëntor 1985.

Fëmijëria e saj u formatua sipas situatës politiko-ekonomike nëpër të cilën po kalonte Shqipëria në atë kohë, e që ishte fundi i komunizmit dhe fillimet dramatike të demokracisë së brishtë. “Kujtimet e mia më të bukura të fëmijërisë lidhen me dashurinë pafund që kam marrë nga gjyshërit e mi, të cilët më edukuan me vlerat e respektit, të moralit dhe më ushqyen me bindjen se nëse punoj me fokusim, do arrij të realizoj çdo ëndërr timen”, kujton Dr. Marsela Ceno, imazhi i numrit të ri të Revistës sonë, “Kosovarja”, gruaja që ka se çfarë të rrëfej..





## MARSELA CENO, NJË HISTORI E GJALLË SUKSESI

“Më 1997 u shpërngulëm në Tiranë. Përfundova me rezultate të shkëlqyeshme Gjmnazin “Petro Nini Luarasi” në vitin 2004.

Studimet e larta për mjekësi të përgjithshme i fillova po atë vit dhe i përfundova në vitin 2010. Pasioni im për mjekësinë më është manifestuar që në moshë të hershme.

Sigurisht, fakti se jam rritur me gjyshërit e mi, më ka bërë gjithmonë të ndjehesha përgjegjëse për shëndetin e tyre, e për këtë arsye nuk kishte asnjë dyshim për mua se unë mund t’u vija në ndihmë gjyshërve e njerëzve të mi të zemrës nëse unë do bëhesha një mjekë e mirë.

Ky vizion me shtyri më vonë që të ndiqja studimet e mjekësisë së përgjithshme në Fakultetin e Tiranës”, kujton ajo.

Ndërkohë, pas diplomimit në vitin 2010, jo vetëm Marsela, por shumë nga të sapodiplomuarit nga Fakulteti i Mjekësisë në atë vit, u gjenden përpara dilemës së madhe se çfarë do të ndodhte më tej...

“Në kohën e diplomimit tim, konkurset për të fituar të drejtën e specializimit në Shqipëri përsëriteshin 1 herë në 4 vjet, kuotat e specializimit ishin shumë të kufizuara dhe kjo e bënte akoma më të pamundur nëpërmjet nepotizmit gjetjen e mundësisë për t’u specializuar në Tiranë.

Ndërkohë, doli lajmi se Gjermania ka nevojë për mjekë dhe pranon mjekë edhe nga Shqipëria. Kjo ishte një shtysë e madhe për të gjithë ne, të sapodiplomuarit, për të provuar fatin tonë në Gjermani”, thotë Marsela.

## MJEKJA E DËSHMUAR ME SUKSESE...

Marsela Ceno, sot mjekë e dëshmuar dhe e njohur, femër shembull me të arritura që meritojnë duartrokitje të gjata, kujton se rrugëtimi i saj në Gjermani filloi në vitin 2012, kur edhe u pranua mjekë praktike në Klinikum Mittelbaden Rastatt, në jugperëndim të Gjermanisë, në degën e kirurgjisë.

Aty ju dha mundësia të bëjë praktikë

6 muaj, deri në marrjen e aprobaionit në vitin 2011 në Universitëat Mannheim.

Dhe, më 1 janar 2013 ka filluar punën mjekë asistente në Departamentin e Kirurgjisë së përgjithshme.

Pas përfundimit të dy viteve Comon Trunk, kaloi në spitalin Klinikum Mittelbaden Baden-Baden, ku u përcaktua për kirurgjinë viszerale.

Nën drejtimin e shefit të saj, Profesor Dieter Berger, zbuloi edhe një tjetër drejtim brenda kirurgjisë viscerale, Hernian, me të cilën arriti të përfundojë dhe punimin e saj shkencor dhe të marrë titullin shkencor Dr. Med. në Universitetin e Ulmit, në vitin 2018.

Dhe, që nga ajo kohë ka qenë e pranishme me ligjërata shkencore në shumë kongrese kombëtare brenda Gjermanisë, por edhe në ato ndërkombëtare, si në Spanjë, Danimarkë, SHBA, Kil, Tajvan, ku edhe është nderuar me çmime për arritjet shkencore.

Dr. Med. Marsela Ceno është anëtare aktive e Shoqatës së Kirurgjisë në Gjermani, e Shoqatës së Hernies në Gjermani, si dhe e Shoqatës Evropiane e Amerikane të Hernies dhe anëtare e Shoqatës së Kirurgëve Viscerale Mbarëbotërore.

## THEMELIMI I SHOQATËS SË MJEKËVE SHQIPTARË NË GJERMANI

Doktoresha shqiptare që bën më të mirën në fushën e saj, e që është edhe simbol i faktit se kur njeriu do edhe ia del, shton se ndërkohë, e që vitet kalonin në Gjermani, e kuptonte se çdo ditë me dhjetëra mjekë shqiptarë jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga Kosova, Maqedonia e Veriut etj., po largoheshin nga trojet e tyre dhe vinin në Gjermani.

“Kuriozitetit për të ditur se kush është larguar nga Shqipëria, ku po punojnë, me çfarë probleme po ndeshën, si po ia dalin të marrin aprobaionin, më shtyu që, së bashku me disa miq e mikeshë të mia, të hidhnim idenë për themelimin e një shoqate, e cila do të quhej “Shoqata e Mjekëve Shqiptarë në Gjermani”, thotë Ceno.

Dhe, ne u interesuam të dimë më shumë për shoqatën në fjalë, qëllimin dhe zhvillimin e saj ndër vite...





“Si fillim, startuam me një faqe në “Facebook” në vitin 2017. E, me anë të kësaj faqe filluam të viheshim në kontakt me miqtë, të njohurit tanë që tashmë po punonin mjekë në Gjermani.

Dhe, duke parë interesimin e madh që zgjoi faqja, pas zhvillimit të logos dhe zgjerimit të rrjetit, vendosa që ta kalonim këtë ide në një nivel më të lartë: nga një grupim në “Facebook”, në një institucion, i cili do të vepronte sipas ligjeve gjermane dhe do të bëhej një zë i fortë i mjekëve shqiptarë në Gjermani, e që numri i tyre shtohet dita-ditës.

Kuvendi i themelimit të Shoqatës u mbajt më 16 shkurt 2019 në Berlin. Ishte një takim legjendar, me më shumë se 70 mjekë nga të gjitha landet e Gjermanisë, por edhe nga Zvicra e Belgjika.

Aty u diskutuan në parim qëllimet dhe synimet e Shoqatës dhe u zgjodh kryesia.

Pas themelimit zyrtar filluam t’i themelonim degët e Shoqatës në të gjitha landet e Gjermanisë. Qëllimi

dhe synimi i Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë në Gjermani ishte identifikimi i të gjithë mjekëve, infermiereve, fizioterapistëve, farmacistëve, mamive, punonjësve të laboratorëve, si dhe të studentëve të mjekësisë që jetonin e punonin në Gjermani, si dhe ndërlidhja mes tyre, e cila lehtëson jo vetëm fazat e parat të integritit nëpërmjet ndarjes së eksperiencës, por krijon edhe një platformë të sigurt për shkëmbimin e eksperiencave profesionale, të cilat ndihmojnë në rritjen profesionale dhe për më tepër krijohen miqësi e njohje, të cilat e bëjnë jetën sociale në Gjermani më të pasur.

Nga ana tjetër, dëshirojmë dhe deri më tash ia kemi dalë të krijojmë ura lidhëse me vendet tona të origjinës. E, këtë e kemi arritur nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme me Odat e Mjekëve në Kosovë e Shqipëri, organizimi i konferencave të përbashkëta, si në Gjermani ashtu edhe në Prishtinë e Tiranë, si dhe mbajtja e seminareve me tema të ndryshme mjekësore, që u ndihmojnë studenteve dhe mjekëve të rinj në vendet tona të origjinës”, thotë Dr. Med. Marsela Ceno.

## SPECIALIZIM PAS SPECIALIZIMI...

Mësojmë se interesim shumë të madh mori Shoqata gjatë kohës së pandemisë Covid-19, kur si shoqatë vendosën numra telefonash dhe adresa e-mail në të gjitha landet e Gjermanisë për t’u dhënë ndihmën e parë të gjithë shqiptarëve që ndodheshin në Gjermani në atë kohë.

Dhe, kjo traditë e mirë e humane vazhdon edhe sot, edhe pse pandemia ka përfunduar.

Dr. Marsela Ceno tregon se çdo ditë ajo personalisht, por edhe sekretaria e shoqatës marrin me dhjetëra telefonata e e-maile nga qytetarë të shumtë shqiptarë në Gjermani, të cilët dëshirojnë të vizitohen e të ndihmohen nga mjekë shqiptarë.

“Jo vetëm komuniteti shqipfolës në Gjermani është rritur shumë viteve të fundit, por edhe komuniteti i specialistëve shqiptarë të mjekësisë. Sipas të dhënave zyrtare të dhomës federale të mjekëve në Berlin, janë të regjistruar në vitin 2021 rreth 1300

mjekë.

E, statistikat jo zyrtare flasin për një numër më të madh...

“Pandemia na vuri në kontakt, të cilat kontakte i kemi vazhduar në kuadër të bashkëpunimit me Shoqatën me mjekët shqiptarë në Austri, Zvicër, Itali, Francë, Belgjikë, Greqi e Amerikë, me të cilët herë pas herë mbajmë konferenca për të shkëmbyer eksperiencat ndërmjet mjekëve shqiptarë në vende të ndryshme të botës.

E, ndërkohë, pas përfundimit të specializimit 6-vjeçar në Baden-Baden për kirurgji viscerale, kalova në korrikun e vitit 2020 në Klinikën Universitare në Düsseldorf, kur përfundova subspecializimin 3-vjeçar, të cilin e përfundova me sukses, duke u bërë specialiste e kirurgjisë speciale viszerale”, thotë Ceno.

## NJË GRUA, NJË PROFESIONISTE, NJË MJEKE E LINDUR PËR TË THYER PARAGJYKIMET E SHOQËRISË

Ekzistojnë shumë paragjykime, meqë një femër e re dhe e bukur nuk pranohet shumë lehtë të shihet si kirurge e aftë, pasi që shumë presin dhe shpresojnë të operohen nga kirurgët meshkuj.

Por, për doktoreshën Marsela Ceno kjo nuk përbën aspak problem.

Ajo është e lindur për t’i thyer të gjithë paradigmat e shoqërisë dhe kjo është njëra nga ato.

Lufta me sëmundjen e pacientit për të fituar gjithmonë jeta mbi vdekjen, është një përgjegjësi shumë e madhe, një frymëzim që vazhdon edhe përtej mureve të spitalit për doktoreshën, sepse kjo e ndërgjegjëson për të kuptuar se sa vlerë ka jeta jonë në momentin që e kemi dhe sa pakup-tim janë shpesh gjërat për të cilat ne ankohemi kur harrojmë se gëzojmë shëndet të plotë.

Dr. Marsela Ceno, potencon:

“Në përfytyrimin tim, salla operatore i ngjan një orkestre të madhe, ku jo vetëm unë si violina e parë, por të gjithë së bashku: anesteziologu, infermierët, asistentët, punojmë në qetësi për një qëllim, që operacioni të



shkojë sa më mirë dhe pacienti të dalë i shëndetshëm nga salla.

E, ajo që shpesh më mungon në punën time si kirurge në Gjermani është pamundësia për t'i thënë në gjyhen time pacientit se operacioni shkoi shumë mirë.

Prandaj, është një kënaqësi dhe përgjegjësi akoma më e madhe kur operoj pacientë, kryesisht, nga Kosova, se me ta flas shqip.

Sidoqoftë, prej prillit të sivjetmë punoj si Kryemjete në kirurgjinë Viscerale. Dhe, në ditën e parë që kam hyrë në sallën operatore në këtë post, ndjeva një emocion të paharrueshëm, kur infermieri i sallës nga Kosova u tregoi kolegëve të tjerë në sallë:

“Ja, më në fund, punon te ne edhe një femër shqiptare si kryemjete!”.

## NË JETË E NË PROFESION GJITHMONË TRIUMFON!

Ja ka dalë në jetë e profesion, është triumfuese, por Marsela kujton se sfidat për të arritur deri në këtë pikë të jetës kanë qenë të mëdha e akoma janë prezent, pasi në fillimet e saj në Gjermani kolegët ishin skeptikë se vinte nga një vend me rrugë të paasfaltuara, pa energji elektrike.

Disa pyesnin me çudi nëse kishte apo jo “waschmaschine”, të tjerët bënin komente të tipit se Shqipëria paska jetuar 50 vjet në komunizëm e demokracia qenka akoma aq e brishtë si një vend nga xhungla.

“Por, unë kuptova se këto ishin problemet e tyre. Mungesa e informacionit nga ana e tyre më shërbyen si shtysë e frymëzim për t'u treguar atyre, brenda një kohë të shkurtër, se një vajze e re, e ardhur nga vendi pa energji elektrike e pa rrugë të asfaltuara, mund të arrijë për një kohë të shkurtër më shumë se çdo mjek i ri gjerman, i rritur e shkolluar në kushte shumë të mira.

Edhe rruga e specializimit si kirurge në Gjermani është e vështirë, me presionin e dyfishtë për të operuar si duhet, në mënyrë që të përfundosh në 6 vjet specializimin, orët e gjata të punës edhe në fundjavë, kontaktet e pakta sociale dhe favorizimi i heshur i gjinisë mashkullore para asaj femërore.

Madje, në Itali ekziston edhe Lëvizja “Nuk jam zonjusha, jam kirurgu”, e cila



tregon se diferencimi gjinor brenda profesionit të mjekut, e për më tepër në kirurgji, është ende prezent dhe ka nevojë akoma për punë.

Zgjidhja e vetme është një përgatitje sa më mirë dhe paraqitje sa më profesionale për ne, vajzat e bukura inteligjente në kirurgji”, thotë Doktoresha Marsela Ceno.

## 1001 SFIDA PROFESIONALE...

Dr. Med. Marsela Ceno, pas rikujtimit të 1001 sfidave për t'u realizuar profesionalisht dhe satisfaksionit që i jep kirurgjia, i rikthehet edhe një herë themelimit të Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë në Gjermani, që, sipas saj, kërkoi një periudhë të gjatë përgatitore.

“Aktivizimi im me Shoqatën që nga viti 2017 e deri më tani më ka bërë të ndjeshme, sepse, përveç meje, Marsela Ceno kirurge, ekziston edhe një Marselë tjetër brenda meje, që ka shumë dëshirë të merret me çështjet sociale të ndjeshme e të prekshme për jetën e komunitetit, pa dashur ta quaj direkt politike.

Secili nga ne, që është i realizuar në fushën e vet, e ndjen si detyrim realizimin e kontributit të komunitetit ku jeton e vepron.

Andaj, si kirurge në Gjermani dhe Presidente e Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë në Gjermani, shumë shpesh më drejtohet pyetja pse largohen mjekët nga Shqipëria, por edhe nga Kosova e Maqedonia e Veriut...

E, studimet e shumta viteve të fundit

kanë treguar se nuk është vetëm paga ajo që i detyron tashmë jo vetëm mjekët e rinj, por edhe ata me eksperiencë të gjatë të largohen nga tokat shqiptare.


Siguria në vendin e punës, mundësia për t'i ofruar pacientit terapinë e duhur maksimale, pa u nisur nga faktorët socialo-ekonomikë (a ofron pacienti mjaftueshëm para nëse e mjekoj), asistenca juridike dhe ligjore që ofrojnë sindikatat, të gjitha këto e bëjnë punën e mjekut në Gjermani shumë të sigurt dhe të mbrojtur.

Nga ana tjetër, decentralizimi i procesit të specializimit, si dhe fakti që çdo mjek specializant paguhet që nga dita e parë që ai fillon të punojë si mjek, përkundrejt kuotave të lira ose të pambuluara në Shqipëri (specializantët paguajnë vetë për të pasur të drejtën të specializohen ose punojnë pa pagesë), i detyrojnë mjekët të drejtohen drejt Gjermanisë.

Sidoqoftë, jam e gatshme që eksperiencën time 10-vjeçare si kirurge, por edhe ekspertizën time në politikat e shëndetësisë, që lidhen me procesin e përmirësimit të sistemit shëndetësor në përgjithësi, si dhe masat që duhen marrë për ndalimin e daljes së trurit nga vendet tona, t'ua ofroj institucioneve përkatëse në Prishtinë e Tiranë”, thotë doktoresha Marsela Ceno.

Andaj, kjo grua e jashtëzakonshme, iniciatore dhe humane, ka një moto që e ndjekë gjithmonë, e që është “Së bashku jemi më të fortë!”.

**Nderim Neziri**



*Temë e nxehtë...*

# Më shumë i ndërrojnë partnerët meshkujt a femrat?

*Femrat janë ato që kanë pasur më shumë partnerë sesa meshkujt. Por, ato i fshehin lidhjet e tyre...*

Pse i fshehin femra partnerët e tyre, është pyetje që femrat nuk japin përgjigje. Përndryshe, meshkujt për lidhjet e tyre flasin me krenari, me mburrje, thonë të anketuarit tanë.

Pra, kush ka pasur më shumë partnerë gjatë jetës: meshkujt a femrat? Në këtë temë flasin të anketuarit tanë...

**L. DINI, MOTËR MEDICINALE, NGA GJAKOVA:**

**TË RRALLA JANË ATO QË KANË DËSHIRË TË KENË SHUMË LIDHJE**

- Nuk pajtohem me ata që thonë se femrat gjatë jetës së tyre kanë pasur më shumë partnerë sesa meshkujt. Sepse, sipas meje, të rralla janë ato që kanë dëshirë të kenë shumë lidhje...

E, edhe nëse kanë pasur, është pasojë e tradhtive që ua bëjnë meshkujt. Sepse, nuk ka si të mos bëhen shumë meshkuj, meqë me secilin që nisë një lidhje të tradhton!

Dhe kjo, fatkeqësisht, meshkujve po u shkon për dore!

Ndërkaq, krejt ndryshe është me femrat, sepse ato një jetë të tillë nuk e duan...

**BURIM M., TEKNIK I DHËMBËVE, NGA FERIZAJ: EDHE FEMRAT KANË QEJF TË KËNAQEN!**

- Nuk janë gjithmonë femrat ato që janë viktima të meshkujve, mbase disa sosh edhe vetë duan që kjo të ndodhë. E, kjo ndodh nga shkak se edhe ato duan të kënaqen si ne, meshkujt! Dhe, shtrohet pyetja: Pse jo? Por, natyrisht, ka edhe meshkuj që i keqpërdorin femrat. I mashtrojnë dhe pastaj ikin prej tyre! E, kjo është poshtërsi...

**DONA E., BIZNESMENE, NGA ZVICRA:**

**MESHKUJT E KOSOVËS JANË PËR KEQARDHJE!**

- Meshkujt e Kosovës shtiren të modëruar sa nuk ta merr mendja! Për ta nuk ka rëndësi a je e virgjër a jo! Jemi në shekullin XXI, kam dëgjuar të thonë shumë prej tyre. E, pjesa dërmuese e meshkujve kur duan të lidhin një martesë me femrën që e dashurojnë duan që ajo të jetë e virgjër. Madje, kërkojnë një të tillë që nuk ka pasur kurrë mashkull!

E, sa femra i ka pasur ai deri atëherë për ta s'ka rëndësi! Qesharake, a?!

**L. LIANI, BIZNESMEN, NGA PEJA:**

**MUA FEMRAT MË AFROHEN VETË!**

- Mua vitin e kaluar një femër që punonte në firmën time vetë m'u afrua dhe

më tha se dëshironte ta kalonte një natë me mua!

E, pse e bëri atë as atëherë e as tash nuk e di, por e di se nuk e pranova kërkesën e saj dhe pas pak ditësh e la punën dhe më nuk e kam parë.

**D. BISLIMI, MJEKE, NGA GJILANI:**

**U MUNDUA TË MË QONTE NË SHTRAT, POR IA BËRAMAT!**

- Unë, sa isha e re, jam munduar ta ruaj virgjërinë. Por, me kohë e kam kuptuar se asnjë mashkull nuk e meriton një gjë të tillë, sidomos kur flasin se si kanë pasur gjatë jetës shumë femra, madje edhe të paqena, sa për lavd! Kohë më parë pata kërkesë për martesë nga një biznesmen dhe, thënë të drejtën, më pëlqente.

Por, pas dy-tre takimeve e kuptova qëllimin e tij të fëlliqur, ku synimi i tij final ishte të shkoja me të në shtrat.

Dhe, deshi Zoti e refuzova dhe bëra mirë që e bëra një veprim të tillë, sepse më vonë e kam kuptuar se ai nuk ishte i duhuri për mua...

**NË VEND TË PËRFUNDIMIT...**

Jeta sjell gjithçka:

Edhe kënaqësi edhe vuajtje.

Edhe gëzime edhe hidhërim.

Edhe mashtrime, edhe triumfe.

Sidoqoftë, jeta duhet të shfrytëzohet se dikur bëhet vonë...

**Diturie Haxhaj**



# UB Gjermane-Shqiptare *me takime, aktivitete, suksese*



*Në qytetin Koblenz, te bashkimi i lumenjëve Rhein dhe Mosel, te Deutsch Eck, Unioni i Bizneseve gjermane-shqiptare në Gjermani organizoi takimin e radhës me strukturat e saja organizative dhe disa nga anëtarët premium të saj.*

Kryetari Nazmi Viqa, duke hapur këtë takim, i njoftoi të gjithë të pranishmit se qëllimi i takimit ishte të falënderohen të gjithë ata që po japin kontribut në zhvillimin dhe rritjen e Unionit të Bizneseve, duke i shpërnda mirënjohje të pranishmëve për kontributin dhe financimin e shoqatës. Mirënjohje u zotuan edhe për anëtarët, të cilët për shkak të kohës së pushimeve nuk arritën të jenë pjesë e kësaj mbrëmje. Falënderimet në shkallë edhe më

të gjerë, planifikohen të bëhen në vjeshtën e këtij viti jubilar, kur edhe Unioni i Bizneseve shënon 10 vjetorin e themelimit të saj. Për organizimin e të cilit, Kryetari mori përkrahjen e të gjitha strukturave të UB që në ditët në vijim të fillohet me organizimin e kësaj ngjarje të veçantë. Në këtë takim të Unionit të Bizneseve i pranishëm ishte edhe afaristi i mirënjohur shqiptar në Gjermani dhe më gjere z. Lazim Destani, i cili në fjalën e tij përshëndetëse i inkurajoi të gjithë

bashkatdhetarët tanë që jetojnë dhe veprojnë në Diasporë të marrin guximin dhe të bëhen ndërmarrës. Vetëm duke u angazhuar me seriozitet dhe vullnet, arrihen edhe rezultat. Duke i ndihmuar vetvetes i ndihmohet edhe rrethit, shoqërisë dhe vendlindjes, theksoi Filantropi Lazim Destani. Gjatë takimit u shkëmbyen ide, propozime dhe u treguan storje suksesi të anëtarëve të pranishëm.

Suksesi krijon lidhjen!





# 3 ëndrra në 3 kohë

*Oda ishte mbushur burra. Qilimat kuq e zi dhe jastëkët e kallpët ngjyrë kuqe, qëndronin pas shpinave të burrave ulur këmbëkryq. Njëri prej atyre që flisnin më së shumti ishte vetëm me një këmbë, sepse këmbën tjetër ia kishin amputuar pas shpërthimit të një granate.*

## ËNDRRA E PARË: SSSSSS... SI JE?

Një burrë, që ishte ulur këmbëkryq në odë, përdridhte mustaqet e bardhë, që i preknin veshët. Ai i kishte mbajtur 12 vjet burg në Mitrovicë të Sremit. E kishin akuzuar se në Kabash të Prizrenit, në një odë, kishte folur se Kosova e Shqipëria duhej të bëheshin një.

Burri tjetër në odë ishte mbi dy metra i gjatë. Ishte nga Sllakoci, fshat në bjeshkë, e ku prioritet i popullatës ishte kujdesi nga ujquit dhe ruajtja e hambarëve nga derrat e egër. Burri i gjatë, që kishte ardhur më qejze, kishte rënë në përroskën e fshatit dhe burrat e lagjes mezi e kishin nxjerrë nga balta. Ai ishte shtrirë në qosh të odës dhe i vendosnin kripë e qepë në këmbët e shtypura. "Si je, mixha Ajet?", e pyeti Bislimi, burrë që erdhi nga jashtë dhe nuk priti përgjigje, sepse e thirrën ta shtronte darkën. Burri që kishte mbajtur burg politik 12 vjet, e pyeti burrin me një këmbë se si jetonte vetëm me një këmbë. I tha se vuajtjet ishin të ndryshme... Unë qëndroja në trapazan, si një fëmijë i vogël, që kisha detyrë t'u jepja burrave ujë me tas... Pas darke u dëgjua një trokitje në derën e odës. Ishte një shok i babait, i cili më shumë belbëzonte sesa që fliste. Bile, më pat rrahur një herë babai pse e imitoja... Ai e zgjaste në fillim shkronjën s. Thoshte: "Ssssss... si je?".

## ËNDRRA E DYTË:

### PLAKU FLISTE ME SULLTAN MURATIN!

Me të gdhirë mëngjesi hodha sytë kah vendi i odës së vjetër, ku kishin kaluar net e net burra të mëdhenj që donin ta thyenin kufirin me Shqipërinë. Oda nuk ekziston më, por trysnia e ëndrrës me burrat e rëndë që flisnin në odë si dikur, nuk më hiqej nga mendja. Isha kthyer në kohë fëmijërie, realisht me po ata burra që kanë qëndruar në odën tonë. "A thua, çka të do del nga kjo ëndërr?", pyeta veten gjatë ditës. Në mbrëmje, në rrugën e vjetër, shirita të verdhë ishin vendosur në shenjë kujdesi ndaj incizimit të vendngjarjes. Ishin plagosur ca djem të rinj... Njëri prej tyre ishte vendosur në shtratin pranë plakut që dergjej nga pleqëria. "Si janë djemtë? A ta kanë hatrin? Sepse, në pleqëri nuk i duhet më shumë njeriut se t'i ketë ngatë vetes fëmijët?", e pyeti plakun. "Po, mirë jemi. Edhe djemtë janë mirë. Ky që më ri afër nuk del kurrë nga shtëpia, e ai që nuk është këtu nuk vjen kurrë në shtëpi! Pra, njërin nuk



mund ta fus brenda kurrë e tjetrin nuk mund ta qes prej shtëpisë!”, ia kthen plaku.

“Po, ç’është kjo punë, njëri jashtë e tjetri brenda?!”, i thotë i riu.

“Nuk di, por vjen Sulltan Murati dhe ua tregon qejfin të gjithëve!”, ia kthen ai. I riu ktheu kokën majtas-djathtas të shihnte se kush do vinte...

E, djali i plakut i tha të mos ia zinte për të madhe çka fliste, se është bërë asfalt...

“Babai është bërë rrafsh! Flet vetë me vete me Sulltan Muratin dhe herë-herë ia hedh nga një cigare!”.

## ËNDRRA E TRETË: HOXHA QË I QETËSONTE ZHURMAX-HINJTË

Burrat në odë e kishin hapur sërish muhabetin. Ata që i kisha parë në ëndërr para disa netësh, tash i shihja në qilima të odës. Një tepih nga Turqia qëndronte në mes të dy pjesëve të odës ku ishte vendosur stufa për ngrohje. Disi, burrat kishin ndryshuar. Nuk më dukeshin se ishin në atë nivel që ishin në ëndrrat tjera.

Një burrë me një këmbë, një ish-i

burgosur dhe një zgatavell, e që kishte rënë në për-rua dhe i përbaltur, fliste pa lidhje si të ishte në agoni. Njeriu pa këmbë kishte ndezur dy cigare.

Ish-i burgosuri fliste për politikë. Cigaret që ia hidhnin të pranishmit i tubonte para vetes. Muhabeti përqendrohej ndërmjet njeriut me një këmbë dhe ish-të burgosurit politik. Shpesh flisnin të dy përnjëherë dhe nuk mund ta kuptonin njëri-tjetrin.

Polemikat mes tyre i qetësonte hoxha, i cili mendohej t’i ofronte.

Ish-i burgosuri kërkonte që Millosheviqit t’i ngrihej një përmendore në Prishtinë, ndërsa Kurtit në Beograd. Babai nuk donte ta poshtëronte odën dhe nuk ndërhynte në bisedë.

Dhe, fjalë pas fjale e zënkë pas zënke, gjendja arriti të tensionohet në odë...

Në këtë moment telefonit tim iu lëshua alarmi. Ishte ora 6 e mëngjesit, kohë kur zgjohem çdo ditë.

U ngrita nga shtrati dhe desha ta pyesja gruan nëse kishte kaluar çdo gjë mirë, apo kishte pasur ndonjë rrapëllimë... Por, ajo ia kishte futur gjumë dhe nuk merrej me ëndrrat e mia...

**Safet Krivaça**

# A duhet ta pres të dashurin tim që është në burg?

Përhëndetj! Jam 20 vjeçe dhe jetoj në Kaçanik. Tri vjet më parë jam njohur me një djalë. Ai më telefonoi rastësisht dhe nisëm të flisnim bashkë. Në fillim nuk e kisha marrë seriozisht, madje bëja shaka dhe tallesha, por me kalimin e kohës bisedat me të nisën të më pëlqenin. Unë nuk kam shumë shoqe, për të mos thënë se nuk kam asnjë, pasi jetoj në periferi dhe nuk guxoj të ndaj diçka me një vajzë të qytezës sime, sepse ajo do të flasë pastaj.

Duke parë se çfarë qyteze është Kaçaniku dhe sa shpejt hapen thashethemet, aq më pak mund të kesh një shok. Kështu e kisha më të thjeshtë që t’i ndaja gjërat që më ndodhnin dhe hallet e mia me një të panjohur, me të cilin flisja vetëm në telefon. Kaluan gjashtë muaj nga koha kur nisa të flisja në telefon me Metin dhe pas këmbënguljes së madhe të tij që të takoheshim pranova. Sajova disa gënjeshtër në shtëpi dhe shkova në Ferizaj për t’u takuar me të. Ishte djalë simpatik dhe më pëlqente të flisja me të. Më kuptonte dhe e kuptoja ose, të paktën, kështu thoshte ai. Pas asaj dite takimet tona bëheshin më të shpeshta dhe mua më pëlqente gjithmonë edhe më shumë.

Në një nga takimet tona të fshehta Meti më propozoi ta kalonim një ditë bashkë jashtë Ferizajt. Isha shumë e lumtur, sepse kishte kohë që prisja të ndodhte diçka e tillë. I thashë menjëherë po, pa u menduar gjatë. E dija që isha dashuruar me të dhe besoj se e njëjta gjë ka qenë edhe me Metin, pasi ai më kishte treguar disa herë se isha një vajzë e veçantë për të. Në atë takim shkëmbyem edhe puthjen e parë. U ktheva e lumtur në shtëpi dhe nga ajo ditë vetëm ëndërroja sesi do të ishte jeta ime me Metin, se sa shumë e doja atë njeri dhe mendoja se më prisnin vetëm gjëra të bukura në të ardhmen, por nuk ishte kështu. Të gjitha ëndrrat e mia do të shuheshin më vonë. Gjithsesi, kemi qëndruar një vit të lidhur, takoheshim më shpesh, derisa Meti më kërkoi që të bënim dashuri bashkë. Edhe pse kisha frikë dhe mendoja se pas kësaj gjërat mund të ndryshonin mes nesh, unë e doja Metin dhe isha e gatshme të bëja gjithçka

për të. Fjetëm bashkë dhe ai u tregua shumë i dashur me mua. Asgjë nga ato që më frikësonin nuk ndodhën. Ne vazhdonim historinë tonë të dashurisë. Në një nga këto ditë, kur prisja me pa durim takimin e radhës me të, më vjen një telefonatë. Ai më tregon se mund të ikte jashtë për pak kohë, por unë nuk duhet të mërzitesha se do të kthehej pak muaj më vonë dhe do të martohej me mua. Ishte hera e parë që dëgjoja të fliste për martesë, por nuk munda të gëzohesha nga ky lajm, sepse më shqetësoi shumë fakti pse kishte vendosur papritur të ikte jashtë. Ngula këmbë t’me tregonte të vërtetën dhe ai më tha se ishte grindur me një djalë tjetër dhe sherri kishte përfunduar keq. Nuk mund të tregoj me fjalë se sa shumë u copëtua zemra ime në ato momente. Ai tani do t’i fshihej për një kohë, por nëse e gjenin çfarë do të ndodhte me lidhjen tonë? Kjo ishte frika ime më e madhe dhe në fakt kështu ndodhi. Dhe, ashtu si mendoja edhe ndodhi: e zunë dhe e burgosën. Ai tani ka gjashtë muaj në burg dhe është dënua 4 vjet. Unë nuk e kam takuar më që nga ajo kohë, sepse nuk mund të shkoj në burg, por kemi folur në telefon. Ai më lutet ta pres. Unë nuk di çfarë të bëj. Ndihej shumë keq për këtë që ka ndodhur dhe qaj pa pushim, sepse e dua shumë, por mendoj se sa e vështirë do të jetë të pres me vite të tëra që ai të dalë nga burgu dhe mendoj se gjërat mund të ndryshojnë gjatë kësaj kohe apo edhe mua mund t’me ndryshojnë ndjenjat për të.

A duhet ta pres këtë djalë dhe t’i sakrifikoj 4 vjet të tëra, apo duhet t’i them se duhet ta vazhdoj jetën time, duke e harruar këtë dashuri?

**Neta, Kaçanik**

**Të të themi harroje e dimë se nuk bëjmë mirë, por edhe të të themi prite derisa të dalë nga burgu, përsëri e dimë se nuk bëjmë mirë, sepse ai pas burgut mund të mos e ketë më ndjenjën ndaj teje.**

**Më e mira e së mirës në këtë rast është ta dëgjosh zemrën tënde. Por, së pari, lëre të qetësohet shpirti yt një kohë e tek pastaj vendos...**



# Dita e qenve...

*Një zonjë me fustan të bardhë, e që duket se ka ardhur nga shtetet e perëndimit, ofrohet pranë grupit të qenve endacakë dhe njërit prej tyre i vendos shuplakën e dorës ndërmjet dy veshëve dhe e ledhaton. I përkëdheluri i zonjës ishte një qen i kuq, por jo edhe i madh sa ishte dikur Sharku i shtëpisë sime. Sharku ynë kishte një laro të bardhë mbi qafë dhe një në maje të bishtit.*

Sot, ngado që kam kaluar dhe ecur, më kanë përcjellë qentë, si të ishte "dita e qenve"!

Tek hy në zyrë, fqinji përballë Redaksisë hap derën e shtëpisë dhe në rrugë përnjëherë dalin pothuajse nja dhjetë qen, që i kishte në oborrin e vet.

Ai mban shumë qenë dhe, nëse për çdonjërin do ia paguanin nga 50 euro, do ta merr një pagë të mirë, bile sa t'i ushqejë mirë qentë që i ka marrë nga rruga.

Dhe, teksa hapi derën e zyrës, një qen që kishte fjetur në shkallë, ngriti kokën sikur donte të më thoshte "mirëmëngjesi"!

E, nëse do më gjuhët, kurrë më afër s'më ka pasur... Por, ai nuk lëviz e as unë nuk e trazoj...

Dhe, në çast më kujtohet një ngjarje që tregohej kur isha fëmijë:

Një burrë e kishte hapur një gropë në oborr, të cilën e kishte mbuluar me bar. Natën në të kishte rënë një ujku dhe me të gdhirë dita i zoti i shtëpisë shih se në gropë ka rënë ujku që ia dëmtonte bagëtinë.

E, duke e parë se ujku nuk mund të dilte nga gropa, ia gjuan disa gurë mbi shpinë, duke i thënë: "Ku je tash? Pse nuk po ngrihesh t'mi dëmtosh bagëtinë?!"

Por, duke hedhur edhe më tutje gurë në gropë, i rrëshqet këmba e edhe vetë bie në të.

"Ti rri në atë qosh e unë në këtë qosh! As mos më prek ti mua e as unë nuk të preku

ty!", i thotë ujkut.

Dhe, teksa m'u kujtua kjo batutë, fqinji tjetër përballë Redaksisë del nga dera dhe i afrohet një veture të parkuar para derës se tij.

Por, kur shoferi i veturës deshi ta hapte derën, ai nuk e linte. I turrej sikur të ishte egërsirë, e jo njeri.

Dhe, në çast, më del para syve pamja e Sharkut tonë. Ai kur i thoshim "ndal" edhe ndalej. Ndërkaq, fqinji nuk ndalej...

E, çka ndodhi me Sharkun tonë?

Kur u kthyem në shtëpi pas lufte, Sharku na u hodh me këmbë mbi krahë. Kuiste me zë vaji...

Në këtë gëzim ai dilte në arat e shtëpisë andej rruge dhe një ditë, tek i ofrohej shtëpisë, ushtarët e KFOR-it e kishin vlarë në arë pak metra larg shtëpisë.

U mërzitëm të gjithë...

Pastaj, erdhën kohë të tjera...

Filluan në fshat rrugicat t'i pagëzonin me emra.

U mbajtën shumë mbledhje, shumë konsultime nëpër lagje e mëhalla. Më thirrën edhe mua të jepja ide për rrugët.

Nuk më plasi zemra deri te një moment kur një burrë propozoi emrin e një burri për emërtimin e një rruge.

E, kush ishte ai burrë?

Në vitet e gjashtëdhjeta, kur kishte ndodhur pastrimi ideologjik i Ballit Kombëtar, që kishte programin për bashkim kombëtar, burri që u propozua për emër të një

rruge kishte marrë pjesë në mbledhjet e kohës që mbaheshin në shkollë.

E, katundarët e sinqertë, duke mos besuar se aty kishte spiunë, kishin folur pa dorëza, duke e ruajtur idealin e bashkimit kombëtar.

Mbledhja kishte zgjatur deri në orën 3 para mëngjesit dhe me të dal nga shkolla, ai ishte përdredhur rrugës nëpër ara e drejt e në polici dhe kishte raportuar për përmbytjen e diskutimeve, duke i hapur UDB-së rrugë për arrestimin e dhjetëra fshatarëve.

Dhe, duke dëgjuar për propozimin për emërtimin e një rruge të fshatit tonë me emrin e spiunit, dola me propozimin që rruga ku ndodhej shtëpia ime të mbante emrin e Sharkut.

Arsyetimi:

1. Sharku kurrë nuk e ka kafshuar askënd pa nevojë!
2. Sharku kurrë nuk është përzier në punët politike e as nuk ka shkuar në polici!
3. Sharku e ka ruajtur lagjen edhe në kohë demonstratash, duke ua zgërdhirë dhëmbët atyre që kujdestaronin nëpër fshat, me pretekstin të mos shpërndanin afisheve dhe parulla "Kosova Republikë"!
4. Sharku gjatë luftës së vitit 1999 nuk e ka lëshuar shtëpinë!
5. Sharku është vlarë nga ndërkombëtarët pas lufte, pak metra larg shtëpisë, pa i bërë asnjë të keqe askujt!

**S. Krivaça**



tourist  
**CAMPING**



Adresa: Shtoj, Ulqin [www.touristcamping.me](http://www.touristcamping.me) Tel: +38269336233 [/touristcamping\\_giovannisbeach](https://www.instagram.com/touristcamping_giovannisbeach)



**Giovanni's Beach**  
COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin [www.touristcamping.me](http://www.touristcamping.me) Tel: +38269825858 [/giovannis\\_beach\\_montenegro](https://www.instagram.com/giovannis_beach_montenegro)



# Pse shqiptarët e Afganistanit jetojnë mbi 100 vjet?

*Në një cep tjetër të botës, mijëra kilometra larg, ekziston një popullsi që ka mbajtur gjallë karakteristikat, gjuhën dhe zakonet pellazge dhe ilire.*

Ata janë vendosur para 2300 vjetësh në rajonin Indokinë, në Qafiristan (sot Nuristan), një vend ku takohen Afganistani, Pakistani, Kina dhe Taxhikistani, pikërisht në zonën ku disa kohë më parë u vra Bin Ladeni, zbuluar fillimisht nga skenaristi amerikan James Hilton, i cili xhiroi një dokumentar të titulluar "Horizontet e humbura".

## KUSH UA RREZIKON ZHDUKJEN E TRADITAVE SHQIPTARE NË AFGANISTAN?

Shkaku se ishte një vend i fshehtë me mijëra vjet, ata i kanë mbajtur gjallë tiparet popullore, gjuhën dhe zakonet arbëreshe-pellazge-iliro-shqiptare. Por tash, pasi talebanët morën në dorë Afganistanin, edhe traditat e kultura e tyre rrezikohet. Në maj të vitit 1983, Ernesto Skura shkroi në gazetën "League" të Antonio Bellushit

një artikull të titulluar "Ilirët në Afganistan". Të njëjtën gjë bëri në librin e tij "Arvanitët" historiani i madh me prejardhje shqiptare, Aristides Kola, i cili përshkruan kohën e vendosjes së ilirëve në këtë vend të largët.

## PASARDHËSIT E USHTRISË SË ALEKSANDRIT

Historia e hulumtuar deri më sot tregon se ata janë pasardhës të 6000 luftëtarëve ilirë, që ikën nga vendi i tyre pas vrasjes së mbretit Kliti nga Aleksandri i Madh rreth vitit 300 para erës së re.

Shkaku i distancës së madhe mbetën atje, sepse s'patën si të ktheheshin në shtëpi dhe nisën të martoheshin me gra vendase. Gjuha e tyre u quajt "burrashka", gjuha e burrave, ndërsa gratë flasin gjuhë tjetër. Karakteristikat e këtyre banorëve janë të ndryshme nga ato të Pakistanit. Ata jetojnë më gjatë dhe kanë flokë ngjyrë kafe. Bëjnë dhe pinë verë, si asnjë popull në këto zona.

Lugina ku ata jetojnë në ditët e sotme quhet "hundëza" (hundë e vogël) dhe, me të vërtetë, ajo mbyllet me një grykë mes dy maleve që e rrethojnë.

Edhe pse vendi është malor, ai është shumë pjellor në prodhimin e perimeve, frutave dhe drithërave të ndryshëm, si: patatet, bizelet, trangujt, gruri, misri, elbi, kajsitë, dardhat, mollët, pjeshkat, kumbullat, fiqtë, qershitë, rrushi, shalqiri etj. Janë miqësorë dhe të dobishëm për njëri-tjetrin. Presidenti i Hundzës e mban titullin Mir (më i miri). Festa e tyre më e madhe

është Viti i Ri diellor (si pellazgët dhe arbëreshët), i quajtur Naurosh (na uroni) dhe është më 21 mars. Pra, me fillimin e pranverës.

Pamja e tyre ndryshon nga pakistanezët, afganët e kinezët. Janë me lëkurë të bardhë e me faqe të kuqe. Shumica kanë sy blu, jeshilë ose gri dhe flokë që variojnë nga e ngjyra e verdhë e misrit në të zezën e korbit. Disa fëmijë kanë flokë të kuq. Në lartësinë e maleve është një fis i madh i quajtur Kalash. Zotat Kalash shfaqen në portat e tyre me një simbol që shpreh origjinën e tyre të lashtë të ilirëve dhe lidhjen e tyre me Aleksandrin e Madh, një dhi me dy brirë, ashtu si ishte edhe përkrenarja e Skënderbeut.

Veshjet e tyre janë si të shqiptarëve në kohët e hershme, me poture dhe këmisha të zbukuruar.

Ndërsa vallet e tyre shoqërohen nga tinguj të baterisë dhe fyellit. Një vallëzim tradicional popullor është kërcimi me shpata dhe na i kujton vallet e Rugovës.

## CILI ËSHTË SEKRETI I JETËS SË GJATË DHE TË SHËNDETSHME TË TYRE?

Ata nuk hanë ushqim të përpunuar, por i konsumojnë produktet që i mbjellin vetë në tokat e tyre. I konsumojnë veçanërisht kajsitë. Ata hanë ushqim dy herë në ditë (një mëngjes të shëndetshëm dhe një darkë të mirë pas perëndimit të diellit). Në vend se të shikojnë filma dhe të qëndrojnë brenda, ata ecin shumë. Dhe, teksa në Pakistan jetëgjatësia mesatare e një personi është 67 vjeç, në Hundëza moshë 100 vjeç është normale.





# BOOM

*Cili është termi  
më i përdorur  
në këngët shqipe  
kohëve të fundit?*

*Ryva Kajtazi,  
e papërshkrueshmja*

*Si i bënë  
për vete femrat  
Capital T?*

*Noizyt  
dikur ja përqeshnin,  
sot ja lakmojnë...*

**Kaltrina  
Zeqiri  
– Kastrati**

*piktorja e rrallë,  
një nga shqiptaret  
më me ndikim në Zvicër*



# E papërshtkrueshmja



*Ryva Kajtazi mbetet gjithmonë mes personazheve më të përfolur të shoubizit. Muzika, aktrimi, jeta private, stili... Ryva përherë ngacmon imagjinatën e publikut...*

**Ç'është më me rëndësi për ty në sjelljen e një projekti të ri?**

- Që brenda tij të ketë frymë timen, si në këngë ashtu edhe në videoklip. Asnjëherë nuk tentoj të ndryshoj në thelb vetëm për hir të tendencave.

**Nëse flasim për matësin e suksesit të një artisti, cili do të ishte ai?**

- Jetojmë në kohën e një mori barometrash, por them se publiku është fjala e fundit.

**Ku ndahen dhe ku takohen muzika, biznesi dhe aktrimi për të cilin je diplomuar?**

- Kudo duhet art, shije, finesë dhe shpirt.

**Në aktrim apo në këngë i ke pasur duartrokitjet më të fuqishme?**

- Duartrokitjet e fundit mbesin në kujtesë.

Pra, janë ato të skenës së muzikës. Por, edhe në aktrim jam duartrokitur gjatë...

**Sakrificat që ke bërë në emër të profesionit?**

- Ndonjëherë duhet të dalësh nga vetja. Mua nuk më pëlqen, por ky profesion ka raste kur të nxjerrë nga lëkura. Besoni, është sakrificë.

**Cilat janë fjalët e duhura për të të përshkruar?**

- E papërshtkrueshme.

**Cila është gjëja së cilës i përkushtohesh më tepër?**

- Familjes, muzikës, shëndetit.

**Ç'mendon kur dëgjon për çifte që bashkohen dhe pas pak ditësh ndahen?**

- Jeta ka të mirat dhe të këqijat e saj. Asgjë nuk është kopsht me lule, e as dashuria.

**Dashurinë dhe urrejtjen një fill i ndanë. Si i shikon, si vijnë te ti këto dy ndjesi?**

- Mua më duket se i ndanë një botë e tërë, sepse ato janë dy botë të kundërta.

**Cila është pyetja që ia bën shpesh vetes?**

- Ku je?

**D. Hajredinaj**





# Noizyt

*dikur ja përqeshnin,  
sot ja lakmojnë...*

*Reperi nga Shqipëria, Rigels Rajku, i njohur me nofkën Noizy, është ndër më të preferuarit nga radhët e reperëve.*

Thuhet se ka pasur e ka shumë femra. E, se adhurohet nga gjinia e bukur kjo është e dukshme dhe vërehet edhe në komentet që lëshohen në rrjete sociale, si dhe nga prania e madhe e femrave në vendet ku ai këndon. Ku është Noizy ka shumë vajza...

Reperi ka arritur t'ua vjedhë zemrat të rejave me sharmin e tij. Komentohen më së shumti buzët e tij mishtore, por edhe trupi muskolor. Noizy ka thënë se dikur në fëmijërinë e tij përqeshej për buzët, që sot ia lakmojnë thuajse të gjitha femrat...

## Si i bënë për vete femrat Capital T?

*Të gjithë i komentojnë linjat e rep-artistit Capital T, që është në top-formë fizike...*

Capital T edhe kur kishte mbipeshë dukej bukur dhe ishte pikë reference për shumë vajza. Capo përherë është paraqitur me stil, unik dhe sharmant. Viteve të fundit po jeton me një regjim strikt në ushqim dhe ushtrime, që i ka mundësuar të krijojë një linjë fantastike trupore.

E, kjo gjë ka bërë që interesimi i femrave për te të jetë i madh. Megjithatë, shumë vajza e vlerësojnë lart edhe modestinë e reperit. Sepse, Capital T nuk është tip mendjemadh. Nuk deklaron asgjë rreth jetës private, edhe pse flitet se është në lidhje me Adrola Dushin.



# Kaltrina Zeqiri – Kastrati, piktorja e rrallë, një nga shqiptaret më me ndikim në Zvicër

*Kaltrina Zeqiri-Kastrati është artiste e lindur. Një piktoreshë unike, e jashtëzakonshme dhe me një botë të madhe shpirtërore.*

*Çdo pikturë e saj është ndjenjë e pasionit, dashurisë dhe emocioneve të forta. Një grua ndryshe, e përmbushur dhe me dashurinë e madhe për të inspiruar e për ta bërë më të bukur botën.*

*Me biografi speciale, Kaltrina Zeqiri-Kastrati e shpalosë veten në “Boom”...*



## **Kaltrinë, biografia juaj?**

- Jetoj në Cyrih, jam 30 vjeçe, e martuar me dashurinë e jetës dhe nënë e lumtur e dy fëmijëve, Kianos dhe Adores.

Fëmijërinë e kam kaluar në Gjermani, ku edhe e përfundova shkollën fillore, ndërkaq të mesmen e kam përfunduar në Kosovë.

Kam punuar edukatore, por që nga viti 2019 merrem kryesisht me art.

Sivjet jam bërë pjesë e galerisë më të madhe të artit në Zvicër, “Fane Gallery” në Cyrih dhe jam shumë e lumtur për këtë fakt.

## **Si e përshkruan veten e si të përshkruajnë të tjerët?**

- Jam shumë energjike, kreative, e ndjeshme, pak kokëfortë dhe këmbëngulëse.

E, të tjerët më përshkruajnë si zemërgjerë, pozitive, kreative, ambicioze dhe karizmatike.

## **Kur dhe si e zbulove afinitetin për art?**

- Që në fëmijëri u zbulua talenti im për art. Kam pasur gjithmonë dëshirë të pikturoj, të këndoj dhe të shkruaj poezi.

Kam marrë pjesë në festivale të ndryshme për fëmijë, sfilata mode dhe recitime.

## **Si u bë piktura prioriteti yti?**

- Në vitin 2019 zbulova tek vetja talentin e pikturimit, ndërkaq sot e bëj si punë profesionale e jo si hobi.

Kur i postova në rrjete sociale fotot e pikturave të mia, pata shumë reagime pozitive dhe një interesim të madh, andaj sot piktura është prioriteti imi.

## **Keni punuar edukatore e artistit. Ç’tha për këtë?**

- Puna edukatore më pëlqente shumë. Dashuria që ma kanë dhënë fëmijët ma ka mbushur zemrën.

Përherë kam qenë mësuese kreative, energjike dhe e dashur për të vegjlit.

Por, meqë e vërejtja se me pikturë puna po më ecë shumë mirë, vendosa ta lë kreativitetin tim të rrjedhë. Arti sjell edhe relaks në familjen time. Kështu, vendosa ta lë punën edukatore dhe të merrem plotësisht me art dhe për këtë jam tejet e lumtur.

## **Ku i ke ekspozuar veprat tua deri më tani?**

- I kam pasur disa evenimente ku i kam ekspozuar pikturat e mia. Në evenimentin “Swiss-Brands” në Cyrih, ku edhe u zgjedha si njëra nga shqiptaret më me ndikim në Zvicër.

Kam pasur edhe një gala event në Bazel të quajtur “Villa Art Show”.

Gjithashtu, pikturat e mia janë të ekspozuara edhe në “Fame Gallery” në Cyrih, ndërkaq mund të gjenden edhe online në veb faqen kaltrina-art.ch dhe në Instagram tek piano adora.

## **E veçanta juaj është se pikturoni live, në prani të njerëzve. Çfarë ndjenje është kjo?**

- Evenimentet ku unë bëj pikturim live më japin një ndjenjë gjithë adrenaline dhe më motivojnë shumë. Emocionet të cilat i transmetoj në pëlhurë me





ngjyra e brushë, janë të pakrahueshme dhe lumturohem pa masë që njerëzit janë apasionuar pas mënyrës sime të pikturimit. E, kjo më jep forcë për të mos u ndalur...

#### **Cili është zhanri juaj në pikturë?**

- Abstrakt me teksturë, por më pëlqen të provoj stile të ndryshme dhe teknika me materiale të ndryshme, që t'i zgjeroj degët në profesionin tim. Mua më identifikojnë pikturat unike e të punuara me pasion.

#### **Kush është muza juaj në art?**

- Është familja ime, ndërkaq frymëzimin e marrë kryesisht nga natyra, ritmi i muzikës dhe dashuria për jetën. Gjithashtu, udhëtimet nëpër vende dhe kultura të ndryshme më frymëzojnë dhe inspirojnë shumë.

#### **A është në planet tua një ekspozitë personale, ndoshta edhe në Kosovë?**

- Kam menduar dhe i kam plane, e që shpresoj t'i realizoj. Në fakt, do të kisha shumë dëshirë

t'i tuboja disa artistë nga Kosova dhe të organizoja një ekspozitë madhështore, në mënyrë që edhe arti i tyre të merr vëmendjen e merituar dhe, kështu, të krijojmë edhe kontakte të vlefshme.

#### **Ndërkohë, si kalon një ditë e juaja e zakonshme?**

- Gjatë ditës merrem me fëmijët dhe kërkesat e tyre. Në studion e punës, që e kam në shtëpi, punoj kryesisht natën.

Për fat të mirë, bashkëshorti më përkrah shumë në realizimin e ëndrrave të mia. Jemi familje artistike, andaj arti është integruar perfekt mes nesh, duke e zbukuruar jetën dhe përditshmërinë tonë.

#### **Gjëja më e rëndësishme për ty?**

- Është familja dhe lumturia e tyre. Gjithashtu, edhe pavarësia individuale dhe ta bëj atë që dua.

#### **Çka të bënë grua të fortë, unike e speciale?**

- Emocionet dhe ndjenjat e mia të forta më bëjnë të paraqes një anë artistike të mrekullueshme. Dashuria për jetën, familjen dhe artin më japin refleksim pozitiv, më bëjnë të mos ndalem së krijuari gjëra të bukura. Pa dashurinë që marrë çdo ditë nga familja ime, nuk do të isha kjo që jam sot...

#### **Pasionet tua të panjohura?**

- Më pëlqen të gatuj ushqime tradicionale, por edhe receta të huaja. Merrem me tre lloj sportesh: me Capoeira (sport brazilian), zumba dhe basketboll. Më pëlqen të bëjë xhiro me motor nëpër vende të ndryshme, ku edhe shkoj me bashkëshortin tim.

#### **Dukesh bukur, me stil. Je e apasionuar pas modës?**

- Moda, veshja, stili, janë një nga pasionet e mia, e që besoj i afekton shumë femra. Mendohej të blej rroba të veçanta, që të kem stilin tim unik.

#### **Mesazhi juaj?**

- Mos u ndalni së besuari në vetë! Punoni me zemër dhe pa i ndalur ëndrrat tuaja! Gjithçka që bëhet me pasion edhe shpërblehet, andaj dashuronit atë që bëni, kujdesuni për veten, për shëndetin dhe për njerëzit që doni... Pavarësisht suksesit, qëndroni gjithmonë të thjeshtë dhe të dashur për rrethin!

**Nderim Neziri**



# Cili është termi më i përdorur në këngët shqipe kohëve të fundit?

*Temë aktuale në shumicën e këngëve shqipe është alkooli. Këtë po e dëgjojmë në këngët dhe tekstet që po transmetojnë te publiku këngëtarët tanë...*



## DIONA FONDA DHE MAJK PINË KA NJË GOTË

Diona Fonda dhe Majk sezonin e filluan me këngën ku teksti fillon me "Pina ka një gotë".



## LUIZI DHE DONALDI: "2 SHOTSA"

Luizi dhe Donaldi, në kulmin e suksesit të tyre, përdorën "Shot-sat", për të qenë afër ndjekësve të tyre. Një pjesë e tekstit të këngës "2 Shotsa" mbeti shumë gjatë në mendjen e adhuruesve të tyre. "Edhe dy shota dhe dy shota për dashni, me fund i pij me fund i pij".



## LEDRI VULA: "NJË GOTË PËR TY"

Ledri Vula mbahet mend me rikthimin e tij në muzikë me këngën "Një gotë për ty". Dedikim apo jo ky ishte çelësi dhe hiti ia hapi rrugët artistike reperit.





### CAPITAL T NUK E LË PA I PIRË DY GOTA!

Në këngën “Dukat”, Capital T nuk e la pa pirë dy gota, ku edhe në tekstin e tij thotë: “Për ty, për ty ka dy gota i pijë, ka dy gota i pijë”.

Edhe kjo këngë u shndërrua hit i momentit.



### NITA LATIFIT NUK I MJAFTON NJË GOTË!

Nita Latifit nuk i mjaftoi një gotë, por “2 Gota”, për t’u kthyer fuqishëm në skenë pas “Big Brother”.



### ALBAN DHE BEATRIX RAMOSAJ PINË “GIN TONIC”


Alban Ramosaj dhe Beatrix Ramosaj zgjodhën pijen “Gin-Tonic” për të nisur sezonin e verës 2023.

### SI TA PËRMBYLLIM KËTË TEMË?

Sidoqoftë, gota është aktuale jo vetëm te këngëtarët, por edhe në shoqërinë tonë. Gota pretendohet se është zgjedhja më e mirë e të gjitha problemeve momentale! E, habitshme, a?!

**Edona Vllasaliu-Bajoku**

REALITET...



# Në Prishtinë krushqit morën nusen gabimisht!

*Sikur e kaluara që sjell përvojën mbi të cilën bazohet njerëzimi, ashtu edhe gabimet janë pjesë jona e jetës.*

Në mëhallën "Kodra e trimave" të Prishtinës, në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën rrugicë paskëshin pasur të shkonin nuse dy vajza.

Do të vinin atë ditë në atë rrugë dy palë dasmorë dhe do i merrnin dy nuse.

Dhe, kur kishin ardhur dasmorët e parë, në hyrje të rrugës kishin hasur në pritjen e miqve. Ndalen aty duke menduar se u kanë bërë pritje në fillim të rrugës, që të mos zhagllavitëshin në rrugicën e ngushtë.

Një krushkë, kur hyjnë në shtëpinë që i priste, vëren se diçka nuk ishte në rregull, por, siç thuhet, "Zoti ja mbylli gojën!".

Por, nusja vërejti se asnjërin nga krushkat nuk e njihte dhe mendja i shkoi se ato krushka janë për nusen tjetër, e që ishte në shtëpinë pak metra larg saj.

Në çast, u thotë krushkave:

"Cila është motra e burrit tim?!"

Një vajzë u ngrit në këmbë dhe tha: "Unë jam".

"Jo, ty nuk po të njoh! Ti nuk je motra e burrit tim!", ia ktheu.

Atëherë, nusja e mençur u tha:

"Keni ardhur gabimisht në shtëpinë time.

Ju keni me marrë nuse tjetër disa shtëpi më larg nga këtu!"



KOHË E KEQE...

## Edhe shqiptarët **po rrahin** babë e nënë!

Lajme tronditëse lexojmë çdo ditë në gazeta e në portale: "Djali rrahu nënën!", "Djali rrahu babën dhe e bëri për spital!", "Nuse e burrë rrahën nënën!" etj., gjëra të cilat më parë nuk kanë ekzistuar te ne, shqiptarët, meqë respekti për prindërit ka qenë i madh, i veçantë.

Por, pas lufte, e veçmas kohëve të fundit, çka s'po ndodhë te ne! Andaj, edhe nuk është habi pse tokën e Kosovës e quajnë tokë të nemun, siç quhen edhe Bjeshkët e Nemuna.

Po, kush na paskësh nemun, ej? Vetëm ne të nemur, kurse të tjerët bëjnë jetë të lumtur?!

Ndoshta jemi të nemun, sepse nuk punojmë për shtetin, nuk punojmë për progresin, siç punojnë të tjerët për shtetin e tyre...

Ne nuk mundohemi të kemi një shtet të fuqishëm, sepse ëndërojmë ta vjedhim sa më shumë...



# J A M B E R

# LIFTING

# I MENJËHERSHËM

PA DHIMBJE! PA KIRURGJI!



  
**allure.**  
BEAUTY

+355 69 211 1919  
@allurebeauty  
Rr. "Reshit Çollaku", Tiranë

# Cili shqiptar i Kosovës jetoi 50 vjet në bunker dhe pse?

*Një kullë e vjetër me dritare sa për ta vendosur tytën e manzerës, rënkon e lodhur nga stuhitë e kohëve. Është shtëpia e vetme në vitin 2005 kur e vizituam, e cila qëndron në atë gjendje sikur është ndërtuar gjysmë shekulli më parë. I zoti i saj është njeriu që ka jetuar në bunker, që hyrjen e ka në oborr e fundin në mal.*

Avdyl Bajrush Gavazi, që shkurt e quajnë (Daku), ishte 70 vjeç kur e vizituam në shtëpinë e tij në fshatin Mirash të komunës së Ferizajt. Ai është legjendë në vete. Historia e tij është formuar në raport me Serbinë dhe përndjekjen e tij për shumë dekada.

Pushteti komunist serb e akuzonte

tërë jetën për vepra të ndryshme penale, ndër të cilat edhe lidhja me Tahir Mehën e Drenicës dhe me disa patriotë të tjerë që kishin shkathtësi fizike të mos binin në duart e policisë serbe.

Avdyl Gavazi ka jetuar në izolim më se pesëdhjetë vjet, në maje malesh të thepisura, i ruajtur nga truprojat më besnike, nga pesë qentë e tij të mëdhenj, në një korridor bunkerit të ndriçuar nga llamba e vajgurit. Njeriu që ka jetuar në mënyrën më të çuditshme për nga mjeshtëria, sot, me mjekër të thinjur dhe me plis e mahramë, i rikujton disa gjëra të hidhura nga jeta e rëndë, qëkur ia vranë partizanët babanë, Bajrushin, në vitin 1947, si ballist i përbetuar për bashkim me Shqipërinë dhe armik i komunizmit. Qanë e flet kur i kujton njerëzit dhe shokët, rrahjet me policët, borën një metër të trashë mbi shpinën e tij, tek dremitej me kokë në jastëkun prej druri dhe guri në krye të bunkerit që dilte te vendi i quajtur “Kodra e Kishës” në bjeshkë.

Avdyl Gavazi ishte kërkuar edhe nga

shërbimi ushtarak jugosllav, sepse policët nuk e kishin kapur kurrë dhe, si i tillë që ishte kishte zgjuar frikën e regjimit për organizime ushtarake.

## AVDYLLIT SERBIA KURRË S'IA LA KILE

Njeriu që jetoi tërë jetën me nder e drejtësi, që në moshën dhjetëvjeçare reagoi me pushkë kundër Serbisë, që instalonte partizanë, që Daku i quan “partizanët e Sllakocit”.

“Isha dhjetë vjeç kur ua ktheva pushkën partizanëve. Unë nuk munda t'i zmbropsja, sepse isha shumë i ri, por prej atëherë më kurrë s'mu hoq gazepi”, thotë Avdyli.

Tregon se e kanë ndjekur brigadat partizane për ta zhdukur nga faqja e dheut, si dhe uniformat policore – ushtarake.

“Prej atëherë kurrë s'kam bërë selamet”, thotë Avdyl Gavazi, njeriu të cilin e kanë quajtur “komandanti i ballistëve”.

Ai tregon se i kanë rënë njerëzit e UDB-së në shtëpi, por edhe për çdo gjë që ka ndodhur jo vetëm në fshat,



por edhe në rrethinë e më larg. Forcat serbe zbarkonin ta kërkonin Dakun në shtëpinë e tij, duke konsideruar si njeri problematik.

Për një pjesë të jetës së vet të mundimshme, ai thotë:

“Pesëdhjetë vjet nuk kam pasur liri në shtëpinë time! Ka pasur të tillë në fshat që më thoshin:

“Ku je ballist?”

E unë, s’mund t’u thosha se s’jam i tillë, pasi babai, Bajrush, ishte vrarë për ideal të tillë”.

Më së paku, çdo ekspeditë që i ka rënë në shtëpi, i ka pasur nga 12 policë, që ai i quan partizanë, me të cilët është rrahur në oborr e në shtëpi.

“Sa herë më kanë rrahur ua kam kthyer, bile edhe më shumë! Sa herë më kanë sharë e ofenduar, ua kam kthyer njëjtë”, i kujton me lot në sy Daku të gjitha ngjarjet e jetës së tij.

## A KA QENË AVDYL GAVAZI SPIUN I AMERIKËS?

Avdyl Gavazi (Daku) mundimin më të rëndë e ka pasur, siç thotë ai, pas arrestimit të Azem Vllasit, kur UDB-a i kishte rënë në shtëpi, me kërkesa të veçanta t’i nxjerrë “aktet e Tahir Mehës”.

Daku mban mend se e ka kryer shërbimin ushtarak me një anëtar të familjes së Tahir Mehës, më 1985. Ai është bërë viktimë e regjimit komunist, nën pretekstin se në bunkerin e tij ruante fshehur aktet strategjike të figurave të forta kombëtare që lidheshin me Tahir Mehën, e që kanë për qëllim rrënimin e Jugosllavisë.

Nuk ishin vetëm listat me emrat e patriotëve të kohës së Mehës pretekst për ta rrahur e arrestuar Dakun, por ishin edhe kërkesat maksimale të regjimit të Jugosllavisë, e që Avdyl Gavazit i kërkonin edhe radio-lidhje speciale amerikane dhe britanike, duke dyshuar se ai ishte spiun i amerikanëve dhe britanikëve.

“M’i kanë shkallmuar robtë e shtëpisë, duke i rrahur dhe munduar shumë”, thotë Daku i përplotur, duke plotësuar tregimin:

“Jam plakur, më ka lënë fuqia, më ka kapluar edhe fukarallëku, se nuk më

ka lënë Serbia sytë me i çel kurrë.

Avdyl Gavazin e njëj rrethi i vet në fshat e më gjerë, si njeri që ka bërë jetë në izolim nga shoqëria, si njeri që jeton pa pasuri, por me qëndrime burrërore dhe me traditën e së kaluarës. Daku ka jetuar në bunker, siç thotë ai, në qelinë e tij, por nuk ka rënë në duart e Serbisë.

Ishte njeriu më i përfolur i kohës për dhjetëra vite për jetën e tij në bunker. Atëbotë, të gjithë mendonin se ai ka përgatitur bunker të gjatë me kilometra dhe përgatitje për luftë me Serbinë. Fillimi i tunelit ishte në një therrinë të maskuar në oborr dhe dalja ishte në majën e një kodre, që ishte rajon i Gjilanit.

“Më merrnin në gojë shumë vendas. Dikush thoshte s’e kam hapur bunker special kundër helmeve të luftës, që atëherë i kishte Rusia, dikush thoshte se po përgatiti luftë kundër Serbisë.

E, qëllimi im ka qenë mos me i ra në dorë Serbisë...”

Dhe, sa njerëzit janë rrah për mua, sa njerëz kanë marrë rryshfet e para të majme për t’më qitur në pritë...”

## TRUPROJAT BESNIKË TË DAKUT

Njeriu që pohon të ketë fjetur në gurë, në vend të jastëkut, ka pasur pesë truproja besnikë, që ishin qentë e tij, që rrinin në hyrje të bunkerit. Qentë e tij kanë vrarë ujqërit që i janë ofruar

bunkerit, e që ishte shtëpia e Avdylit.

Dhe, për të gjitha këto, Daku thotë:

“Bunkerin e kam ndriçuar me fener vajguri. Ushtria serbe ka ardhur me qentë e vet specialë për t’më kapur, por qentë e mi kanë fituar karshi qenve të ushtrisë jugosllave.

Luftëra e tyre është zhvilluar te “Kodra e Kishës”...

Forcat jugosllave kanë zbritur aty me parashutë, për t’më kapur në befasi dhe për t’i gjetur letrat e tapive, që mendonin se ndodheshin në një çantë të babait tim, i vrarë nga partizanët më 1947.

Më patën thënë disa herë shkijet - sillu aktet e babës tënd se çka kishte menduar ai për serbët dhe për Adem Gllavicën...”

E, babai im i kishte letrat e tapive të shqiptarëve që malazezët ua kishin marrë tokat në kohën e kolonizimit...

## KUR U KTHYE DAKU NË SHTËPI?

Daku ka zbritur në shtëpinë e tij me fillimin e shkatërrimit të Jugosllavisë, i përballur me skamje dhe vuajtje, nën diktatin e sëmundjeve që i solli mali dhe koha.

Në luftën e vitit 1999, nën oborin e shtëpisë së vet u ka dalë përpara tankeve të ushtrisë serbe dhe u ka bërë titur: “Qëlloni në këtë gjoks!”

Por, ata nuk e vranë...”

**S. Krivaça**

Radio,  
Lajme, Moti,  
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin  
shkabaj për Android

ANDROID APP ON  
Google play



**BREZOVICA**  
HOTEL & SPA



**REZERVO TANI!**

+383 49 30 10 30

Përjetoni të jashtëzakonshmen në  
1100 metra lartësi mbidetare  
[www.brezovicahotel.com](http://www.brezovicahotel.com)



**KEN DA**  
CENTER  
BY SHKENDA DUBOVA

**Dobësohu lehtë pa dhimbje  
dhe shëndetshëm.**

[www.kendacenter.com](http://www.kendacenter.com)







# Burri im është homo e unë me tjetrin!

*Burri im refuzoi të merrte ndihmë nga mjeku për problemet që kishte me ereksion, kështu që iu dorëzova tundimit dhe e tradhetova.*

Jam nga Gjakova. E martuar para 10 vjetësh. E, si i kalova këto 10 vjet vetëm unë e di, kurrë pa u kënaqur.

Para 11 vjetësh, posa e përfundova shkollën e mesme, në qytetin tim të lindjes, në Gjakovë, u njoha me një infermier dhe, thënë të drejtën, më pëlqeu që në shikim të parë.

Aso kohe thashë: Shkollën e mesme e kreve, e gjeta të dashurin dhe sikur ta gjeja edhe një punë...

Por, që në fillim të lidhjes sonë hetova se me të dashurin tim diçka nuk ishte në rregull, sepse, edhe pse takoheshim çdo ditë, nuk insistonte që të kryenim marrëdhënie seksuale.

Kjo, thënë të drejtën, më habiste shumë... Por, mendoja se është i turpshëm dhe me kalimin e kohës, pasi të martohemi, gjërat do të ndryshonin...

Dhe, ndodhi si ndodhi e pas një viti u martuam, pa bërë asnjëherë seks më parë.

## PËR HERË TË PARË SEKS – NË NATËN E MARTESËS!

Në natën e martesës më s'kishte ku të shkonte. U shtrimë në shtrat, nisëm lojën e dashurisë dhe bëmë seksin e parë bashkë, ani pse unë më parë e kisha një të dashur, për të cilin burri im e dinte.

Edhe netëve të tjera bënim seks, por burri im nuk kishte ejakulim të mjaftueshëm, kështu që asnjëherë nuk arrija orgazmën. Pas nja tre muajsh martesë i thashë të shkonim te mjeku dhe të kontrolloheshim të dy, e jo vetëm ai.

Por, arsyetohej se me kohë do lirohej nga stresi që e kishte...

## KUR E ARRITA ORGAZMËN E PARË?

Ndërkohë, gjeta një punë në një butik të njohur të Gjakovës, e që pronari ishte nja dhjetë vjet më i vjetër se unë.

Në fillim çdo gjë sillej në raportin shëf-punëtores, por më vonë nisi t'më pyeste edhe për jetën time familje, e edhe atë private.

Pa fije turpi një ditë më tha:

"A po të kënaqë burri në shtrat?"

U skuqta. Mbete e shtangur nga ajo pyetje

provokuese...

"Po", i thashë me gjysmë zëri.

Por, ai hetoi se ajo "po" ishte e zbehtë dhe m'u afrua afër e më rroku për krahu.

Nisa të dridheshja. E di se u skuqta shumë në fytyrë dhe një temperaturë ma përshkoi trupin.

Dhe, pa një e pa dy më ka tërhequr kah vetja dhe më ka shtërnguar për beli. Në çast, kur deshi t'më puthte, e largova kokën dhe ai më lëshoi, nuk përdori dhunë.

E, kjo bëri që pas dhjetë minutash t'i afrohem vetë dhe iu ula në prehër...

Ai, në çast më tha të ngrihem dhe u nis kah dera. Kur iu afrua derës, e rrotulloi çelësin dhe dera u mbyll me çelës. M'u afrua, më rroku për dore dhe u nisëm për në zhveshtoren, ku klinetët i provonin rrobat. Më puthi, nisi t'më zhvishte dhe pas pak më shtriu në dysheme fillikat të zhveshur.

Në ato çaste përjetova kënaqësinë që më mungonte, sepse, edhe pse isha e martuar, isha e etshme për seks.

Por, pas një orë seks të pandërprerë, e që m'i hapi të gjitha "diznet", kur kryem punë, më tha:

"Kjo më nuk përsëritet kurrë! Më fal, por nuk dua t'ua shkatërroj jetën gruas sime, fëmijëve të mi, por as ty!"

**Verimja, Gjakovë**





# “Marina Bay Resort & Casino” për pushime të një niveli tjetër

“Marina Bay Resort Casino” është përfundimisht vendi më i denjë për pushime të jashtëzakonshme. Nuk ka asgjë që i bënë konkurrencë kur është fjala për kënaqësi, relaks dhe adrenalinë.

“Marina Bay Resort & Casino” garanton një eksperiencë ndryshe pushimesh, sepse është kompleks që ofron gjithçka në një vend dhe që zgjon ndjesinë e kënaqësisë së plotë.

Luksi me të cilin është ndërtuar, ngritur dhe detajuar ky resort, bënë që pushimet tuaja të marrin kuptim tjetër, plotësisht të një tjetër niveli dhe klasi.

Siç dihet, ‘Marina Bay Resort & Casino’, është njëri ndër resortet më të frekuentuara edhe nga fytyrat publike, sepse ofron shërbimet më të mira turistike në të gjithë Shqipërinë, duke filluar nga mikpritja, akomodimi e deri te pijet dhe ushqimi.

Njihet si kompleksi më luksoz në bregdetin shqiptarë dhe jo kot, me që në këtë vend do kaloni momente relaksi e po ashtu edhe jetë nate nga muzika live e deri në lojërat e fatit në Marina Bay & Casino.

Pamja që ofrohet është brilante, njëjtë si resortit sensacional, i vendosur në pozicionin më të veçantë, për të ofruar pamje fantastike në 360 shkallë.

Krejt kësaj shtojani edhe ndjesinë e mahnitshme të notit në ujin e pastër të pishinave apo duke e provuar edhe një SPA.

‘Marina Bay Resort & Casino’, vendi i ëndrrave që s’mund të mbyllen në sirtar!



**Mandarine Restaurant  
by Marina Bay**  
+35533410000  
+355696041000

**Lime Lounge by Marina Bay**  
+355696041001  
info@marinabay.al  
www.marinabay.al

**Adresa:** Vlorë, Shqipëri



# Më dridheshin këmbët kur hyra dhëndër!

*Xha Ferizit, fqinjit tim, para dy vjetësh i vdiq gruaja dhe në pleqëri e la vejan. Kur i thoshin se a po mërzhitesh që mbete pa grua, u thoshte se mërzhitej shumë, sepse grua si soji i saj sot nuk gjendet dot...*

“Në ditë, kur erdhi daja te ne, i tha babait tim se unë jam rritur e bërë për martesë. E, siç tha ai, ma ka gjetur një nuse dhe është e shtëpisë së mirë...”

Dhe, fill pas asaj dite daja kishte shkuar mesit për mua...

Më kujtohet, tri javë rresht daja endej poshtë e lart mes babait tim dhe familjes së nuses derisa u dha pajtimi nga ana e

familjes së nuses që pranuan fejesën tonë dhe e “solli dorën”, siç thuhej në atë kohë, duke i thënë babait në odën tonë:

“Në emër të Zotit, ta ka dhënë çikën Ejupi, që e ke lypë për djalin tënd, Ferizin!”

Baba i tha dajës:

“Për hajr na qoftë kjo punë, o mik!”, duke u ngritur në këmbë e duke u marrë ngrykë ndërmjet veti.

E, pas drekës së mirë që u shtrua në odë, u përhap lajmi te familjarët e mi se mua më kishin fejuar.

Më pas, pas dy muajsh, babai me axhën i dërguan do sende te nusja, kryesisht gjësende që nevojiteshin për qëndisje...

## KISHA DËSHIRË TA SHIHJA TË FEJUARËN, POR AJO FSHIHEJ!

Një vit më vonë dërguan edhe gjëra të tjera dhe vadja për dasmë u caktua një vit e gjysmë pas fejesës sime, edhe pse kurrë të fejuarën time nuk e pashë asnjëherë para martesë, sepse ajo fshihej nga unë.

E, në ditën e dasmës, kur edhe nisën të vinin të ftuarit, e që në atë kohë i qua-

nim krushq, nisi edhe dajrja me tupan e surle dhe zëri i tyre dëgjohej fund e krye katundit...

Në kohën kur shkuan krushqit ta merrnin nusen, unë u veshja mirë, i krega flokët më mirë se kurdoherë tjetër dhe prisja me pa durim ardhjen e nuses, e që një minutë më dukej sa një orë.

Megjithatë, kaloi edhe ajo ditë dhe erdhi koha të hyja dhëndër. Këmbët më dridheshin para atij akti të paharrueshëm të jetës sime...

## E PASHË NUSEN PËR HERË TË PARË NË NATËN E MARTESËS

E kam parë për herë të parë gruan time atë natë që ma sollën në shtëpi. Ishte e re, e bukur si hëna.

Dhe, vit pas viti ma mbushi shtëpinë me fëmijë. Shtatë fëmijë i ka rritur dhe kurrë një fjalë të keqe s’e kam dëgjuar prej saj... E kam dashur, e kam nderuar e respektuar dhe kurrë nga mendja nuk më hiqet, edhe pse ka dy vjet që Zoti ma mori dhe më la pa të...

S. M.



# remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës  
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja  
Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,  
Westerwald, dhe Urmitz.

Na kontaktoni ne [info@remos-restaurants.de](mailto:info@remos-restaurants.de)



[remos\\_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)

| [info@remos-restaurants.de](mailto:info@remos-restaurants.de)

| [www.remos-restaurants.de](http://www.remos-restaurants.de)

# Prej se u ndava nga burri u kënaqa!

*Prej se jam ndarë nga burri u kënaqa. Më nuk po ka kush ma çanë kokën, kush më rri mbi krye, kush më bërtet e qorton çdo ditë...*

Jam nga Prizreni, e martuar para dy vjetësh me një burrë nga fshati i rrethinës sonë. Në fillim të njohjes me burrin tim ishte mirë, çdo gjë shkonte si ishte më së miri.

Por, qëkur u fejuam, gjërat nisën të ndryshonin. Nuk e di pse në fillim sillej mirë me mua?! Ndoshta pat qëllim vetëm të më bëj për vete.

Dhe, kur më përvetësoi dhe mori nga unë gjithçka i nevojitej, nisi t'i qes "brirët": Mos u vish provokueshëm!

Mos u vish hollë e ngushtë! Mos shko te dajallarët! Mos shko te tezet! Mos shko të vajzat e hallës!  
E, ndalesa të tjera m'i bënte çdo ditë...

## **BURRI IM NGA NJË MELAQE U BË DREQ!**

Pra, i fejuari im nga një melaqe u bë dreq dhe çdo ditë e më shumë e urreja.

Dhe, erdhi edhe dita e martesës. U martuam si është më së miri. Në fillim përsëri nisi të sillej mirë. Thashë me vete: Ndryshoi, më në fund!

Por, ai ndryshim ishte i përkohshëm. Përsëri nisi me avazin e vjetër... Zotit çdo ditë i lutesha të ma bëj një qare, sepse martesë si timin mos pastë kush.

Dhe, ndodhi si ndodhi, vendosa të ndahesha.

Më mirë një ditë të qaja sesa tërë

jetën, i thashë vetes.

Në fillim e pata vështirë, por me kohë nisa të adaptohesha, të mësohesha me jetën vejushë.

Nisa të dal mbrëmjeve me shoqet e dikurshme, të rrija edhe me shokë, aq sa një ditë njërit iu hodha në krah dhe drejt e në dhomën e tij.

Ishte një kënaqësi e paharrueshme, pa maltretime e mundime. Ishte një ndjenjë që nuk e kisha përjetuar më parë, ndoshta pse isha e çliruar psikikisht apo kisha nevojë për një ndjenjë të tillë.

Andaj, në mbrëmje i shkrova një sms ish-burrit tim, jo që ta nevrkosja, por t'ia thosha të vërtetën se mirë kam bërë që jam ndarë nga ai, se sjelljet e këqija që i kishte ai ndaj meje më detyruan të ndahem nga ai...

Shkurt e shqip: la pushë hajrin ndarjes...

**Timja, Prizren**





# Arsim Kabashi falënderon qytetarët e tifozët për sukseset historike të "FC Ballkani"



Presidenti i klubit, Arsim Kabashi në një shkrim në Facebook, drejtuar të gjithë qytetarëve të Komunës së Suharekës po ashtu edhe tifozëve të klubit të njohur duke i falënderuar në mbështetjen në çdo moment për FC Ballkanin, pos tjerash thotë : jam i nderuar të jem njëri prej akterëve të përfshirë në sukseset historike të klubit tonë të zemrës , në të cilat secili nga ju e kuvendin e vetë, pasi pa përkrahjen dhe mbështetjen gjithëpërfshirëse s'do të ishim ku jemi sot.

## STATUSI I PLOTË

Të dashur qytetarë të Suharekës, tifozë të zjarrtë Xhebraila dhe gjithë ju mbështetës të FC Ballkanit nga mbarë vendi. Sezoni që shkoi nuk ishte aspak i lehtë, i luftuar deri në fund, por që me mbështetjen e secilit dashamirë të skuadrës tonë historike, ia dolëm të arrijmë objektivin primar që kishim, shpalljen kampion në Superligën tonë shtetërore. Titulli i dytë radhazi, padyshim që kreytve

na ka dhënë ndjenjë gëzimi, por assesi nuk na ka dhënë ndjenjën e vetë-mjaftueshmërisë. Përkundrazi e ka rritur etjen për suksese të tjera, të cilat do të nisim t'i ndjekim menjëherë, që nga kampanja e Evropës, Superkupa e Republikës dhe kompeticionet tjera që nisin në edicionin e ardhshëm. Jam i nderuar të jem njëri prej akterëve të përfshirë në sukseset historike të klubit tonë të zemrës, në të cilat secili nga ju e ka vendin e vetë, pasi pa përkrahjen dhe mbështetjen gjithëpërfshirëse, s'do të ishim ku jemi sot. Andaj të bashkuar drejt qëllimeve të përbashkëta, do të vazhdojmë edhe më tutje, për ta dërguar Ballkanin tonë, lartë e më lartë. Nesër po e fillojmë rrugën e Evropës, të motivuar e me moral të lartë. Faleminderit të gjithëve, nga mbështetësit në tribuna, futbollistëve, stafit teknik, bashkëpunëtorëve dhe gjithë shqiptarëve kudo ndodhen. Na priftë e mbara! Perzemersisht, Arsim Kabashi FC Ballkani.



## MAGJISTARJA

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)



Për hapje të fatit, për stresse, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

*kontaktoni në këtë email adresë:*

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)

### **Nuk ma gjejnë diagnozën!**

E dashura magjistare, jam 51-vjeçare, jetoj në Gjilan. Kam mpirje të këmbëve dhe shpesh edhe të dorës së majtë. Kam bërë shumë analiza, por, përkundër analizave dhe ekzaminimeve, nuk ma kanë përcaktuar akoma diagnozën. Ç'të bëj? Të shkoj për analiza mjekësore në Shkup apo në Shqipëri?

**"Lulja"**

### **Përgjigje:**

Zakonisht, mpirja e gjymtyrëve, si e ke shpjeguar ti, është problem që vjen nga përkeqësimi i sistemit nervor, por vendin se ku është dobësimi duhet përcaktuar mjekësia. Megjithatë, pa dashur ta marr rolin e ekspertit adekuat për të folur për mjekët tanë dhe mjekësinë, ja vlen të tregohet një anekdotë:

Ishte sëmurë Nastradini

dhe shkoi te mjeku. I tha atij t'ia gjente sëmundjen...

*"Nuk ke ti sëmundje, Nas-tradin, por je i uritur. T'i thuash gruas të ta pjekë një pulë", i thotë mjeku.*

*"A ka nevojë edhe ndonjë gjë tjetër?", i thotë Nas-tradini.*

*"Kjo mjafton", ia kthen mjeku.*

*Dhe, kur u kthye Nastradini në shtëpi, i tregoi gruas çka i kishte thënë mjeku...*

*E, pasi u ngop mirë, Nas-tradini shkoi te mjeku.*

*"Vërtet, ti qenke doktor se jo mahi! Ma gjete diagnozën me të parën! Ma gjete ilaçin dhe nuk shkoj askund tjetër...", i tha Nas-tradini.*

*Andaj, të them: Qetësoje shpirtin dhe kjo do të largohet vetë!*

### **Pse burri s'ka ndjenja për mua?**

Përsëritet zonja magjistare! Jam një grua,

39- vjeçare. Kam fëmijë. Jetoj jashtë vendit.

Ka kohë që burri nuk ka ndjenja për mua. Jam munduar në shumë aspekte ta ofrojë pranë vetes, duke e ringjallur nga ana emocionale, por kot.

Kemi biseduar herë pas herë për këtë problem dhe nuk e di arsyen pse po ndodh kjo gjë.

Më është bërë bajat jeta me të dhe nuk di çka të bëj tutje...

Kështu nuk jetohet...

Të ndahem apo të jetoj pa u kënaqur kurrë?

Çka më këshillon, zonjë e nderuar?

**"E brengosura I"**

### **Përgjigje:**

Para së gjithash, duhet të dihet e vërteta pse ka ndodhur ky defekt. Nëse ndryshimi ka ndodhur për shkak shëndetësor, duhet ta pranosh jetën e tillë si bashkëshorte besnike.

E, nëse ndryshimi te burri ka ndodhur shkak i aventurave të tij, e drejta jote për të zgjedhur një mënyrë jete që të përshtatet është në anën tënde.

Ky është një standard parimor i përafërt edhe me kodin popullor dhe me atë shkencor e social.

Por, ajo që shoh unë për



*ju është se asnjëri nuk jeni besnikë ndaj njëri-tjetrit! As ti nuk je në nivelin e ndjenjave për burrin, e as ai për ty!*

*Sidoqoftë, nuk duhet ta prishni bashkëshortësinë, meqë asnjëri nuk jeni në rregull.*

*Ai e ka hetuar gjendjen tënde dhe ka ndryshuar negativisht ndaj teje, prandaj duhet të bashkëbisedoni dhe ta harroni të kaluarën që u ka bezdisur në deharmonizimin bashkëshortor.*

## **Çka do të ndodh me mua?**

Jam lexuese e rregullt e rubrikës tënde. Kam mësuar shumë prej juve, edhe pse nuk kam pritur që unë do e kem radhën të të pyes për problemet e mia.

Problemi im është:

Jam martuar verën që shkoi. Kam pasur një të dashur që jeton në Zvicër. Kemi qenë bashkë gjashtë vite.

Familja ime nuk deshi që unë të martohem me të. Pat ndikim në martesën time dikush tjetër, që nuk po mundem ta dua. Po jetoj duke e dënuar vetveten çdo ditë e më shumë...

Kur ia shpjegova të dashurit tim se po jetoj

duke e dënuar vetveten, më tha nëse e lë burrin do më merr për grua... A do të bashkohemi ne që duhemi?

**“Vij pas teje”**

## **Përgjigje:**

*Në fakt, kështu si po jeton sot, nuk është jeta dënim vetëm për ty, por dhe për burrin tënd. Sepse, duke mos qenë e disponuar ndaj tij, edhe ai dënohet çdo ditë e më shumë. Gjëja më e mirë është ndarja dhe bashkimi me marrëveshje me atë që duheni. Kjo është mënyra më e mirë nëse ekziston disponimi ndër familjar te ju që të kuptoheni për ndarjen.*

*Por, unë nuk jam adhuresse e të jetuarit me çdo kush me dikë që nuk e do në asnjë mënyrë, sepse duke jetuar me zor, ju e dënoni shpirtin tuaj.*

*Ti dhe burri duhet të keni jetë të lumtur dhe ta doni njëri-tjetrin.*

*Por, nëse kjo nuk ka mundësi, vlen ta realizosh edhe skenarin që me të dashurin të kuptoheni dhe të bashkoheni. Sepse, raste si ju ka mjaft...*

*Ismail Kadare thotë:*

*“Dashurinë kurrë nuk e ka dënuar askush në botë!”*

*Pra, nuk do ju dënojnë as juve...*

## **PËR LEXUESIT E DIASPORËS**

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

## **A do më merr në Zvicër ai që më propozoi martesë?**

Përhëndetje zonja magjistare! Jam një zonjë e ndarë nga burri, nënë e tre fëmijëve.

Burri mori grua tjetër dhe mua m’u imponua ndarja. Jemi në proces gjyqësor. Fëmijët janë me mua.

Unë kam dal nga shtëpia, kurse ai jeton me gruan e re.

Sidoqoftë, para pak kohësh kam gjetur një njeri që jeton në një shtet perëndimor, por është më i moshuar se unë.

Më ka premtuar të më merr atje...

A do më plotësohet kjo dëshirë?

**“A do më merr?”**

## **Përgjigje:**

*Personi që të ka bërë ofertë jeton në Zvicër.*

*Por, ju e dini se atje është shumë vështirë të bëheni me letra përkatëse si grua e atij personi.*


*Sidoqoftë, shoh se ai do të të merr në Zvicër, por shtrohet pyetja: Kujt do ia lësh fëmijët?*



# DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE





Contact- Reception - +38260008002  
tel. +38269610003 +38269607865  
hotel.continental.ulcinj@gmail.com

 /hotel\_continental\_ulcinj





**SHERWOOD**  
*Resorts and Hotels*



**GREENWOOD**  
*Resorts and Hotels*

*feel the legend*

**SHERWOOD**  
*exclusive Kemer*

**SHERWOOD**  
*exclusive Lara*

**SHERWOOD**  
*Dreams Resort*

**3UE**  
THE BLUE  
Belek

**SHERWOOD**  
*Premia Hotel*

**GREENWOOD**  
*Kemer Resort*

**GREENWOOD**  
*Suites Resort*

[www.sherwoodhotels.com.tr](http://www.sherwoodhotels.com.tr)